



Kompania Rajonale e Ujësjetlësit

“Hidroregjioni Jugor” SH.A.


“Vatrat Shqiptare”, p.n. 20000 Prizren

Tel/Fax; 029/ 244-150 029/ 244-107

E-mail; sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetlësit “Hidroregjioni Jugor” Sh. A, në Prizren, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.03.2021 mori këtë:

VENDIM



Menaxhmenti i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh. A, miratoi njëzëri raportin vjetor për vitin 2020 në mbledhjen e mbajtur me datë 09.03.2021.

Vendimi të i dorëzohet:

NJPMNP-MEA

Arkivës

Për KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A

U.d- K.E. Zenel Zenelaj



2020

RAPORT VJETOR



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

info@hidroregjioni-jugor.com

konsumatori@hidroregjioni-jugor.com

1.Përmbajtja

Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”

4

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

6

2.1	Të dhënat kryesore gjatë vitit 2020	6
2.2	Te dhenat per drejtot jo- ekzekutiv	8
2.2.1	Emrat e drejtove te bordit te drejtove (Te përkohshëm)	8
2.2.2	Numri i takimeve te bordit te drejtove	9
2.2.3	Numri i takimeve te komiteteve te bordit	10
2.2.4	Informacionet e tjera te bordit gjate vitit	10
2.3	Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividenden	18
2.4	Kredit e rëndësishme te nenshkruara apo paguara gjate vitit	19
2.5	Investimet gjate vitit 2020	19

3 RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

22

3.1	Ngjarjet kryesore te vitit	22
3.1.1	Aktivitetet nga Shërbimi Teknik	22
3.1.2	Situata e furnizimit – NJ.P. - Janar –Dhjetor 2020	22
3.1.3	Aktivitetet kryesore	22
3.1.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	34
3.1.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	35
3.1.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	35
3.2	Pasqyrat e performancave operative nga Shërbimi Teknik	36
3.2.1	Prodhimi – Janar-Dhjetor 2019-2020	36
3.2.2	Prodhimi – Realicimi i cazeve -2020	38
3.3	Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	39
3.3.1	Aktivitetet kryesore- Janar –Dhjetor 2020	39
3.3.2	Raport I ankesave teknike dhe komerciale	39
3.3.3	Raporti ekipes se inspektimit dhe shkyçjes	40
3.3.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	40
3.3.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	40

3.3.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	41
3.4	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë- Nr. I Faturave	42
3.4.1	Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2020	42
3.4.2	Numri i Faturave- 2019-2020	43
3.4.3	Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2020 (Caqet – PB-2020)	44
3.5	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë - Faturimi – m3	45
3.5.1	Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2020	45
3.5.2	Faturimi – m3- 2019-2020	46
3.5.3	Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2020 (Caqet – PB-2020)	47
3.6	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë- Faturimi – €	48
3.6.1	Faturimi €- Janar-Dhjetor-2020	48
3.6.2	Faturimi €- 2019-2020	50
3.6.3	Faturimi €- Janar-Dhjetor-2020 (Caqet – PB-2020)	51
3.7	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë - Arkëtimi – €	52
3.7.1	Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2020	52
3.7.2	Arkëtimi €- 2019-2020	54
3.7.3	Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2020 (Caqet – PB-2020)	55
3.7.4	Tarifat €- 2015 -2020	56
3.8	Raporti nga Shërbimi financiar	57
3.8.1	Aktivitetet kryesore - Janar –Dhjetor 2020	57
3.8.2	Arsyeshmëria e shpenzimeve	58
3.8.3	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	59
3.8.4	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	60
3.8.5	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	60
3.9	Performancat Financiare - Shpenzimet €	61
3.9.1	Shpenzimet € - 2019-2020	61
3.9.2	Shpenzimet € - Janar-Dhjetor -2020 (Caqet- PB- 2020)	62
4	Personeli	63
4.1	Personeli – Janar-Dhjetor 2019-2020	63
4.2	Personeli – Janar-Dhjetor – 2020 (CAQET- PB-2020)	63

5	TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCAVE	64
5.1	Performancat – Janar-Dhjetor - 2020	64
5.2	Performancat – Janar-Dhjetor – 2019-2020	65
5.3	Performancat – Janar-Dhjetor – 2020 (Caqet – PB – 2020)	66
6	Aktivitetet e Departamentit Administrativ	68
6.1	Aktivitet kryesore	68
6.2	Raport i zyres ligjore	73
6.3	Lendet qe rrezikojne Kompanine	75
7	RAPORT I AUDITORIT	82
7.1	Raport i auditorit te brendshem	82
8	KTIVITETET E ZYRËS SË PROKURIMIT	85
9	TRANSAKSIONET KRYESORE	88
10	PASQYRAT FINANCIARE	89
11	Prespektiva per vitin e ardhshëm	94
12	Rreziqet e të ardhmes	95
13	Investimeve e realizuara – Janar-Dhjetor 2020	97
14	Plani I investimeve kapitale- kanalizim per vitin 2020	98
15	Raportet nga Menagjeret e projekteve	106
	ORGANOGRAMI	120

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

2.1 Të dhënat kryesore gjatë vitit

FURNIZIMI

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regjional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania ka arritur që në muajt Janar-Dhjetor të vitit 2020 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në dite. Duhet theksuar se në muajin Janar-Dhjetor në disa pjesë rurale në nivel regjional kemi keqpërdorime enorme të ujit të pijes, prandaj dhe kemi planifikuar restreksione në disa fshatra në nivel regjional. Për me gjëresisht janë prezente tabelat e reduktimeve nga njesite operuese të cilen mund ta gjeni në njesite perkatese.

Në njësitë tjera operuese si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjeset urbane, mirpo duke u bazuar në raportet e njesive operuese për shkak të keqpërdorimeve kemi aplikuar reduktime të planifikuara si dhe në varesi të defekteve të mundshme dhe ndërprerjeve të energjisë elektrike nga KEDS kemi ndërprerje të furnizimit me ujë të pijes *(për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njesive Operative nga udheheqsit e Njesive)*.

Vlen të ceket se në muajt Janar-Dhjetor në nivel regjional kemi patur ndërprerje të ujit për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, prandaj si Departament Teknik sygjerojmë që furnizimi me energji elektrike të jetë prioritet nga ana e KEDS-it.

Në muajt Janar-Dhjetor në përgjithësi kemi patur furnizim të rregullt me ujë të pijes dhe aktivitete të duhura në mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, furnizimi me ujë të pijes ka qenë 24 ore/dite, duke garantuar shtypjen e nevojshme dhe cilesi të ujit 100%.

UJI I PRODHUAR

Për muajt Janar-Dhjetor 2020, në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **16,520,232.00 m³**, krahasuar me vitin 2019, kemi një rënie të prodhimit të ujit të pijes prej **133,095m³**.

FATURIMI - m³

Gjatë vitit 2020 në nivel regjional janë faturuar **7,387,826 m³** me një rritje të faturimit prej **+39,935 m³ (+0.54%)** krahasuar me vitin 2019.

FATURIMI - €

Gjatë vitit 2020 në nivel regjional janë faturuar **4.552.654,76 €** me një rënie të faturimit prej **-267.004,31 € (- 5.54%)** krahasuar me vitin 2019.

ARKËTIMI - €

Gjatë vitit 2020 në nivel regjional janë arkëtuar **4.168.419,17 €** me një rënie të arkëtimit prej **-392.161,83 € (-8.6%)** krahasuar me vitin 2019.

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha sherbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve në kohe sa më shpejtë.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për muajt Janar-Dhjetor, 2020 është **55.28 %** me një rënie prej **0,60 %** nga 2019.

SHPENZIMET - €

Gjatë vitit 2020 në nivel regjional shpenzimet kanë arritur në **3.943.386,65 €** me një rënie të shpenzimeve prej **-34.050,95 € (-0.86%)** krahasuar me vitin 2019.

MBULIMI OPERATIV

Gjatë vitit 2020 në nivel regjional Kompania ka arritur të ketë mbulim operativ prej 1.06 apo **+225.032,53 €** mbi shpenzimet operative.

2.2 TË DHËNAT PËR DREJTOR – JO- EKZEKUTIV

2.2.1 Emrat e drejtorëve të përkohshëm të bordit të drjetorëve

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.11/56 të datës 30.10.2015 emrohet bordi i drejtorëve i përbërë nga 6 drejtor:

- **Rexhep Manxhuka** - Kryesues i Bordit
- **Ridvan Hoxha** - Anëtar i Bordit
- **Alban Zulfaj** - Anëtar i Bordit
- **Ylber Kuqi** - Anëtar i Bordit
- **Ramadan Abazi** - Anëtar i Bordit
- **Reshit Makica** - Anëtar i Bordit

Besim Baraliu - Anëtar i Bordit - (Kryeshef Ekzekutiv)

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës shkarkohet Bordi i lartë shënuar duke emëruar Bord të Përkohshëm të Drejtorëve me vendim nr. 03/26 të datës 23.04.2020 i përbërë nga 4 drejtor:

- **Ylber Elshani** - Kryesues i Bordit
- **Arjeta Vula** - Anëtare e Bordit
- **Altin Sahiti**- Anëtar i Bordit
- **Edmond Halimi** - Anëtar i Bordit

Zenel Zenelaj - Anëtar i Bordit (U.D - Kryeshef Ekzekutiv)

Me datë 03.08.2020 Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/19 shfuqizon vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/26 të datës 23.04.2020, duke emëruar Bord tjetër të përkohshëm në përbërje prej 4 drejtorëve:

- **Zambeze Guraziu** - Kryesuese e Bordit
- **Edmond Hoxha** - Anëtar i Bordit
- **Mirzet Dzokovic** - Anëtar i Bordit
- **Agron Shala** - Anëtar i Bordit

Zenel Zenelaj - Anëtar i Bordit - (U.D -Kryeshef Ekzekutiv)

2.2.2 Numri i takimeve të bordit gjatë vitit 2020

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN
(të Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.11/56 të datës 30.10.2015)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	30.01.2020	Prizren	
2	06.02.2020	Prizren	
3	28.02.2020	Prizren	

MBLEDHJET E BORDIT TË PËRKOHSHËM I DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN
(të Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.03/26 të datës 23.04.2020-03.08.2020)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	24.04.2020	Prizren	
2	27.04.2020	Prizren	Takim i jashtzakonshëm
3	07.05.2020	Prizren	
4	19.05.2020	Prizren	
5	04.06.2020	Prizren	
6	17.06.2020	Prizren	
7	16.07.2020	Prizren	
8	29.07.2020	Prizren	

MBLEDHJET E BORDIT TË PËRKOHSHËM I DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN
(të Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.05/19 të datës 03.08.2020-03.02.2021)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	10.08.2020	Prizren	
2	12.08.2020	Prizren	Takim i jashtzakonshëm
3	07.09.2020	Prizren	
4	07.09.2020	Prizren	MPVA
5	12.10.2020	Prizren	
6	26.10.2020	Prizren	
7	23.12.2020	Prizren	

2.2.3 Numri i takimeve të Komitetit të Auditimit gjatë vitit 2020

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	27.01.2020	Prizren	Emëruar nga MZHE - 23.11.2015
2	05.05.2020	Prizren	Emëruar nga MEPTINIS - 23.04.2020
3	11.06.2020	Prizren	
4	06.07.2020	Prizren	
5	01.09.2020	Prizren	Emëruar nga MEA- 10.08.2020
6	02.10.2020	Prizren	

2.3.4 Informacione të tjera të bordit gjatë vitit 2020

KUR Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren është udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 11/56 të datës 30.10.2015. Ky Bord ka qenë i përbërë nga 6 drejtorë, ndërsa Komisioni i auditimit me 3 anëtarë.

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës shkarkohet Bordi i lartë shënuar duke Emëruar Bord të Përkohshëm të Drejtorëve me vendim nr. 03/26 të datës 23.04.2020 i përbërë nga 4 drejtor (Kryesues dhe drejtor Ylber Elshani, Arjeta Vula-Pozhegu- drejtore, Altin Sahiti-drejtor, Edmond Halimi- drejtor).

Me datë 03.08.2020 Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/19 shfuqizon vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/26 të datës 23.04.2020, duke emëruar Bord tjetër të përkohshëm në përbërje prej 4 drejtorëve (Kryesuese dhe drejtore Zambeze Guraziu, Edmond Hoxha-drejtor, Mirzet Dzogovic- drejtor, Agron Shala- drejtor).

Gjatë vitit 2020 Bordi i Drejtoreve ka mbajtur 16 takime të rregullta dhe 2 takime të jashtëzakonshme.

Në këto takime angazhimet e bordit kanë të bëjnë me:

- Miratimin e raportit vjetor për vitin 2019
- Miratimi i raporteve tremujore/2020 sipas ligjit për NP
- Aprovimi i Plan Biznesit për vitin 2020-2022.
- Aprovimi i Revidimit të Plan-Biznesit për vitin 2020-2022.

- Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, “Mbi Ndërmarrjet Publike”, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009 si dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L - 016, “Për Shoqëritë Tregtare” neni 197 i këtij Ligji është aprovuar nga Bordi Ndryshim Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës “Hidroregjioni Jugor “SH.A, në Prizren, Nr. 01/06-11, datë 30.10.2009.
- Aprovimi I raportit mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2019 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren.
- Është mbajtur Mbledhja së Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U.”Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren (për vitin 2019), ku janë miratuar nga Bordi Pasqyrat Financiare 2019 të audituara nga Zyra Kombëtare e Auditimit në mbledhjen e Përgjithshme Vjetore.
- Raportet e Zyrtarit të auditimit të brendshëm.
- Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve të KRU”Hidroregjioni Jugor”SHA në Prizren, përfshin aktivitetet kryesore të Bordit të Drejtorëve të realizuara gjatë vitit 2020, duke u bazuar në procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Bordit të Drejtorëve.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 30.01.2020 pas shqyrtimit të bërë ka marr këtë vendim:
 - Bordi i Drejtorëve me Vendim miratoi kërkesën e Menaxherit teknik për plotësim të rregullores për sistematizimin e vendeve të punës edhe me pozitat e punës :Recepionist në ITUZ, punëtor furnizues ne ITUZ, punëtor higjiene- bife ne ITUZ, punëtor- mirëmbajtës i jashtëm i objekteve dhe parkut në ITUZ, ngasës i pajisjeve makinerive interne në ITUZ dhe ngasës i cisternës shtytëse ITUZ.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 06.02.2020 pas shqyrtimit të bërë ka rekomanduar dhe marr vendim:
 - Në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U” Hidroregjioni Jugor”Sh. A, pas shqyrtimit të bërë njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM-4 për vitin 2019.
 - Pas shqyrtimit të raportit lidhur me lendet e dërguara të përmbaruesi privat rekomandim i Bordit ishte që të vazhdohet me dërgimin sa më shumë lëndëve në përmbarim ndaj konsumatorëve borxhlinj që nuk paguajnë shërbimet e ujit .
 - Bordi i Drejtorëve aprovoi Strukturës Organizative të K.R.U”Hidroregjioni Jugor”Sh.A, të propozuar nga Këshilli Ndërmnistror për ujëra.
 - Bordi i Drejtorëve aprovoj raportin e regjistrimit vjetor të Kompanisë për vitin 2019.

- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 28.02.2020 në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore, pas shqyrtimit të bërë miratoi Raportin vjetor Operativ dhe Financiar për vitin 2019.
- Bordi i Përkohshëm Drejtorëve në takimin informues te mbajtur me 24.04.2020 u prezantua Bordi e ri i Kompanisë të Emëruar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 03/26, të datës 23.04.2020. Në këtë takim Bordi kërkoi nga menaxhmenti i kompanisë që të i dërgohen me post elektronike të gjithë drejtorëve të Bordit, Plan Biznesi I Kompanisë, Raportet e Auditorit të jashtëm për tri vitet e fundit, draft pasqyrat financiare të kompanisë për vitin 2019 si dhe raportet e auditorit të Brendshëm për tri vitet e fundit të KRU “Hidroregjionit jugor” Sh.a Prizren.
- Bordi i Përkohshëm I Drejtorëve në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur me 27.04.2020 ka marr këto vendime:
 - Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit “Hidroregjioni jugor” Sh.A, Prizren, në përbërje të plotë në mbledhje të jashtëzakonshme duke u mbështetur të nenet 18 dhe neni 21.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-009 , njëzëri mori VENDIM që të i ndërpritet kontrata e punës Kryeshefit Ekzekutiv z. Besim Baraliu në KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh. A, Prizren.
 - Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit “Hidroregjioni jugor” Sh. A, Prizren, në përbërje të plotë në mbledhje të jashtëzakonshme, duke u mbështetur të nenet 18 dhe neni 21.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, i ndryshuar me ligjin Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-009 , njëzëri mori VENDIM ku Emërohet Ushtrues Detyre i Kryeshefit Ekzekutiv z. Zenel Zenelaj.
I njëjti do të kryej punët dhe detyrat e punës me të gjitha të drejtat dhe kompetencat të cilat i ka KE i K. R. U”Hidroregjioni Jugor” SH. A. me seli në Prizren, të cilat i takojnë sipas Statutit të Kompanisë dhe Ligeve në fuqi lidhur me organizimin e Ndërmarrjeve Publike.
 - Drejtorët e Bordit në këtë takim diskutuan mbi raportin vjetor 2019, duke analizuar pasqyrat financiare me theks të veçantë pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e pozitës financiare me ndryshimet në llogarit e arkëtueshme, llogarit e pagueshme, obligimet ndaj kontributeve dhe tatimeve, raportin e auditimit të Jashtëm për vitin 2018 (nga Zyra Kombëtare e Auditimit), si dhe rreziqet me të cilat kompania mund të ballafaqohet në vitin aktual dhe në vitet e ardhshme duke ju referuar raportit vjetor 2019.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 07.05.2020 në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Raportet mbi

Përmbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, me Vendim njëzëri miratuan raportin mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2019 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren.

- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 19.05.2020, mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009 si dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L-016, "Për Shoqëritë Tregtare" neni 197 i këtij Ligji, njëzëri miratoi Vendimin për Ndryshim të Statutit të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" SH.A, në Prizren, Nr. 01/06-11, datë 30.10.2009.
 - Në këtë takim në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM-1 për vitin 2020 .
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 04.06.2020 diskutoj për përgatitjen e një strategjie mbi daljen e kompanisë nga kriza financiare për shkak të borxheve ndaj Kek-ut, ATK-së, obligimet ndaj kredisë, operatorëve ekonomik si dhe shpenzimet e obligimeve mujore të Kompanisë.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 17.06.2020, konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21 Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave mori Vendim të përgatitet Konkursi për Kryeshef Ekzekutiv të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren. Konkursi para publikimit të i dërgohet për njoftim dhe konfirmim Kryesuesit dhe drejtorëve të Bordit të Përkohshëm të Kompanisë. Përveç tjerash në konkurs të kërkohet që kandidati të ketë diplomë universitare në lëmin e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë, juridik apo nga fushë-veprimtaria e Ndërmarrjes (së paku 4 vite studimi pas shkollës së mesme).
 - Bordi i Përkohshëm i drejtorëve, në këtë takim miratoi pasqyrat financiare të kompanisë për vitin 2019 me vërejtjet e paraqitura gjatë diskutimit nga Kryesuesi i Bordit dhe vërejtjet e paraqitura në takimin e Bordit të datës 07.05.2020.
- Rekomandimet e dhëna nga Bordi në këtë takim kanë qenë: Bordi kërkon nga menaxhmenti i kompanisë në bashkëpunim me zyrën e prokurimit t'i planifikojnë aktivitetet me njësitë kërkuese me qëllim që të eliminohen aktivitetet që nuk janë të planifikuara në Plan biznes. Rekomandimi i dhënë është bazuar në vërejtjet e ZKA dhe AB.

- Bordi Rekomandon menaxhmentin e kompanisë që të eliminohen dukurit e inicimit të proceduarave të pa planifikuara dhe të zvogëlohet apo minimizohet përdorimi i aktiviteteve apo blerjeve me kesh.
- Bordi i Drejtorëve vlerësoi të mbetet përgjegjësi e Auditorit të Brendshëm që të auditoi menaxherin e kontratës, të merren disa mostra të disa kontrata si p.sh, kontrata me vlerë minimale, të mesme dhe të mëdha dhe të shikohet sa janë respektuar procedurat, afatet, plani i punës, raporti i pranimit, ndëshkimet etj.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 16.07.2020, duke u bazuar në kërkesën e Ministrisë të Ekonomisë dhe Ambientit z. Blerim Kuçi, Nr. 718 të datës 07.07.2020, drejtuar BD të Ndërmarrjeve Publike që të pezullohen të gjitha proceset e rekrutimit për zyrtarët e lartë të NP, merr Vendim për pezullim të Përkohshëm të proceseve të rekrutimit sipas konkursit me Nr. 01-06/01 të datës 17.06.2020 për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh. A Prizren .Pezullimi i Përkohshëm i proceseve të rekrutimit të Kryeshefit Ekzekutiv të KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh. A Prizren, vlen deri të krijohet mundësia asistencës së Ambasadës Britanike në proceset e rekrutimit të Kryeshefit Ekzekutiv të KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh.A. Krejt kjo duke u bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit për pozitën e larta drejtuese të nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar me datë 02.07.2020.
 - Në këtë takim në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të TM-2 për vitin 2020 .
 - Lidhur me shfrytëzimin e pronës për hulumtime të burimeve të ujit në fshatin Budakovë, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve rekomandoi që kjo çështje të mbetet të iniciohet nga komuna e Suharekës sepse sipërfaqja e pronës nuk është në kuadër të zonës së menaxhimit të kompanisë si dhe kompania nuk ka mundësi buxhetore.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 29.07.2020 në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, për Plan-Biznes, me Vendim miratoi revidimin e Planit të biznesit për vitin 2020 ndërsa të dhënat e planifikuara për vitin 2021 dhe 2022 të plotësohen, ndryshohen gjatë planifikimeve vjetore dhe aplikimit tarifor në pajtim me ARRU-në.
 - Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në këtë takim u pajtuan njëzëri që të vazhdohet me procedurat e rekrutimit të Kryeshefit Ekzekutiv në KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh. A, Prizren sipas konkursit me Nr. 01-06/01. Për hir të transparencës së

kërkuar edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, të ftojnë me shkresë zyrtare OJQ - BIRN dhe NJPMNP-MEA për monitorim të procesit rekrutues apo përzgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv në KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren.

- Nga Bordi i Përkohshëm i drejtorëve, u vendos që ditëve ne vijim të caktohet data e hapjes së aplikacioneve të kandidatëve që kanë aplikuar për Kryeshef Ekzekutiv në KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh .A, Prizren.
- Bordi i Përkohshëm Drejtorëve në takimin informues të mbajtur me 10.08.2020 u prezantua Bordi e tjetër i Përkohshëm i Kompanisë të Emëruar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 05/19, të datës 03.08.2020. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve kërkuan që në raportet mujore të performancës përveç raportit të shpenzimeve të përfshihen edhe pagesat mujore të kompanisë ndaj të tjerëve. Njëherit Bordi kërkoi nga menaxhmenti i kompanisë që të i dërgohen me post elektronike të gjithë drejtorëve të Bordit, Plan Biznesi i Kompanisë për vitin 2020, Draft raporti i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019, raportin vjetor 2019 dhe raportet për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur me 12.08.2020 në përbërje të plotë në mbledhje të jashtëzakonshme duke u mbështetur në kërkesën e Ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit z.Kuqi drejtuar BD të Ndërmarrjeve Publike që të pezullohen të gjitha proceset e rekrutimit për zyrtarët e lartë të NP, njëzëri mori Vendim të Anullohet konkursi i shpallur për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve me datë 07.09.2020 ka mbajtur mbledhjen e Përgjithshme vjetore me Aksionarin të K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren. Bordi i Përkohshëm Drejtorëve në Mbledhjen Përgjithshme Vjetore me Aksionarin miratoi Pasqyrat Financiare të Audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019.
 - Bordi i Përkohshëm i drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin e miratoi Raportin vjetor për vitin 2019.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 07.09.2020, pasi shqyrtoi kërkesën e ish Kryeshefit Ekzekutiv dhe u njoftua që kjo lëndë është në procedurë Gjyqësore, nga Bordi nuk i pa shqetësim lidhur me këtë lëndë dhe vlerësoi që Gjykata do të vendosë lidhur me këtë lëndë (lëndën e ish Kryeshefit Ekzekutiv).
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 12.10.2020, pas diskutimit të gjatë dhe mospajtimit nga shumica e drejtorëve të Bordit lidhur me kërkesën e Drejtorit të Bordit z. Shala për të shtuar në rend të ditës për diskutim edhe Vendimin e Inspektoratit të Punës së Prishtinës lidhur me ish Kryeshefin Ekzekutiv, me shumicë votash vendosen që të shtyhet takimi i Bordit për një ditë tjetër.
- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 26.10.2020, në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për

Plan-Biznes si dhe në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike për Plan-Biznes, njëzëri miratoi Plan Biznesin e KRU" Hidroregjioni Jugor"Sh. A, për vitin 2021-2023, duke përfshirë edhe Strukturën Organizative të Kompanisë .

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në këtë takim, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar të për TM3/2020 të KRU" Hidroregjioni Jugor"Sh.A .

- Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me date 23.12.2020, bazuar në kompetencat komfor nenit 7, paragrafi 2 i Statutit të K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, si dhe kërkesat që dalin nga Neni 34.3 i Ligjit Mbi Ndërmarrjet Publike, aprovoi "Rregulloren për pagat në KRU" Hidroregjioni Jugor"Sh. A, Prizren.

Raport vjetor i punës së Komisioneve të Auditimit, për vitin 2020.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit të KRU" Hidroregjioni Jugor"SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2020.

Bazë e të dhënave për përgatitjen e këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Komisionit të Auditimit.

Në bazë të procesverbaleve, për këtë periudhë raportuese janë mbajtur gjithsejt 6 takime të komisionit, në të cilat janë diskutuar dhe janë marrë disa vendime. Ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike janë paraqitur të gjitha takimet dhe aktivitetet e Komisionit të Auditimit, të mbajtura gjatë këtyre datave: 27.01.2020, 05.05.2020, 11.06.2020, 06.07.2020, 01.09.2020 si dhe 02.10.2020.

1. Në takimin e parë të këtij viti, të mbajtur me 27.01.2020 (Alban Zulfaj - Kryesues i Komisionit të Auditimit, Ylber Kuçi- anëtar, dhe Ramadan Abazi-anëtar), janë shqyrtuar dhe diskutuar disa raporte dhe çështje, sikurse janë:

- Performanca operative e financiare TM4 /2019 dhe realizimi i caqeve,
- Raporti mbi treguesit operativ Janar- Dhjetor 2019 dhe realizimi i caqeve të planifikuara,
- Shqyrtimi i raportit për lëndët që janë proceduar tek përmblyesit privat në të tri kategoritë për periudhën Janar-Dhjetor 2019,
- Obligimet ndaj furnitorëve si dhe pagesat që janë bërë për periudhën Janar-Dhjetor 2019,
- Projektet e realizuara në vitin 2019 të cilat janë të regjistruara në Kontabilitet dhe të cilat janë të parapara për këtë vit,

- Aktivitete e prokurimit te planifikuara edhe ato qe kanë dal nga revidimi i Planit te Biznesit për vitin 2019,
- Raporti tremujor TM3/2019, plus 5 raportet e auditimeve të brendshme, si dhe
- Plani strategjik i auditimit te brendshëm 2020-2022, dhe Plani Vjetor i auditimit te brendshëm 2020.

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë genë:

- K.A kërkon nga Departamenti me konsumator që të paraqesë plan detal te veprimit në përgjithësi (rritjen e faturimit, zvogëlimin e faturimit me tarifë fikse, rritjen e inkasimit, arsyetimi i vazhdueshëm se është dera e konsumatorit e mbyllur etj).
- K.A kërkoj nga zyrtari financiar që në takimin e radhës së Komisionit të Auditimit të paraqesë një pasqyrë te të hyrave nga tarifa në emër te Impiantit në vitin 2019.
- K.A kërkoj që për takim të Bordit të paraqitet pasqyrë e detajuar lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes se automjeteve në shume prej 63.662.59€.
- K.A pas diskutimit të bërë kërkoj që të rishikohet baza ligjore për ndëshkim të punëkryesve ne Impiant për shkak të vonesave në kryerjen e punimeve sipas planit të paraparë për Impiant.
- K.A rekomandon Bordin e Drejtorëve të kërkoj nga menaxhmenti i kompanisë që të gjitha punësimet brenda kompanisë të paraqiten ne bord me arsyetim paraparakisht, ne mënyrë që të jemi ne përputhje me aprovimin e numrit të punëtorëve nga ARRU për vitin 2020.
- K.A pas shqyrtimit të raportit të performancës për TM4-2019 aprovoi të njëjtin me rekomandimet, komentet dhe sugjerimet shtesë të dhëna për shërbimet e Kompanisë.
K.A kërkoj që të informohet për përgjigjen përfundimtare që do të epet nga ATK-ja.
K.A kërkoj që obligimet ndaj furnitorëve të kryhen konform kushteve te kontratës së nënshkruar dhe kornizën kohore për të cilën është lidhur kjo kontratë.
K.A kërkoj që për takim të Bordit të paraqitet krahasim i projekteve që kanë qenë të planifikuar në planë biznes 2019 me projektet që janë të realizuara dhe te regjistruara në kontabilitete përmes zyrës së prokurimit në vitin 2019.
K.A njëzëri Aprovoj Raportin e TM3 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2019.
K.A kërkoj nga departamentet dhe shërbimet përkatëse të Kompanisë të implementojnë rekomandimet e Auditorit të Brendshëm konform kornizës kohore te parashikuar nga Auditori i Brendshem.
K.A pas shqyrtimit të bërë, njëzëri aprovoj Planin Strategjik të punës së Auditorit të Brendshëm, për periudhën 2020-2022, të Planit Vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020.
K.A kërkoj nga Zyrtarin kryesor financiar që pas tre muajve të paraqesë raport lidhur me rënien e pagesave nga Kompania me Kesh apo pagesave me te gatshme.
Mbeti që raporti i Auditorit të Brtendshëm për TM4-2019 të paraqitet në takimin e radhës së komisionit të auditimit.

2. Takimi i dytë i K.A është mbajtur me datë 05.05.2020, (Altin Sahiti - Kryesues i K.A, Arieta Vula-Pozhegu – anëtare dhe Edmond Halimi – anëtar) është diskutuar:

- Statuti i Auditimit të Brendshëm,

- Plani i Auditimit vjetor 2019,
- Auditimet e kryera gjatë vitit 2019,
- Plani i Auditimit vjetor 2020,
- Auditimet e kryera gjerë me 30 Prill 2020, si dhe
- Të tjera.

Duhet theksuar se takimi i dytë i K.A, ishte më tepër me karakter njoftues dhe raportues, nuk ka pasur ndonjë vërejtje në punën e auditimit të brendshëm, nuk janë nxjerrë konkluzione apo vendime, mirëpo ka paraqitur disa kërkesa për takimet e radhës, sikurse:

- K.A vlerësoj që Auditori i brendshëm të paraqesë propozimet e tij ne takimet e radhës të komisionit, që aty ku mendon se është e nevojshme të ndryshohet apo të plotësohet Statuti i Auditorit të Brendshëm.
- K.A kërkoj nga menaxheri i projektit dhe zyrtari i aseteve që të paraqesë informatë në takim të Bordit se deri ku është mbërri puna e vlerësimit të aseteve te kompanisë dhe kur përfundon.
K.A kërkoj nga Zyrtari Kryesor Financiar që në takim të Bordit të paraqesë analizën e kostos financiare për rritjen e vlerës së koeficientit te të gjithë punonjësve gjatë vitit 2019.

3. Takimi i tretë i Komisionit të Auditimit, në përbërje Altin Sahiti - Kryesues i K.A, Arieta Vula-Pozhegu – anëtare dhe Edmond Halimi – anëtar, është mbajtur me datë 11.06.2020 ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve, sikurse:

- Opinion nga Auditori i Brendshëm ne lidhje me rreziqet e Kompanisë,
- Rishikimi i raporteve te auditimeve te kryera gjate 2020,
- Ri-programimi i auditimeve për vitin 2020, si dhe
- Çështje të ndryshme.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave, Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit aprovoi raportin e Auditorit të Brendshëm lidhur me rreziqet e Kompanisë duke vlerësuar rreziqet e paraqitura ne raport.
- Pas diskutimit te bërë u kërkuu nga Sekretarja e kompanisë që zyrtarisht te kontaktoj me Agjencinë Kundër Korrupsionit lidhur me deklarimin apo jo te pasurisë nga drejtorët e Bordit te Përkohshëm të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh .A Prizren, si dhe të vërtetohet periudha e deklarimit te pasurisë nga të njëjtit.
- K.A aprovoi raportet auditimeve të vitit 2020 të prezantuara nga Auditori i Brendshëm, duke kërkuar që të adresohen te gjeturat dhe rekomandimet nga ana e shërbimeve përkatëse.
- K.A kërkoj nga Auditori i Brendshëm që auditimi i radhës me qenë menaxhimi i llogarive te arkëtueshme të periudhës aktuale dhe borxheve te akumuluaru në Departamentin për Konsumatorë.

4. Takimi i katërt i Komisionit të Auditimit, në përbërje Altin Sahiti - Kryesues i K.A, Arieta Vula-Pozhegu – anëtare dhe Edmond Halimi – anëtar, është mbajtur me datë 06.07.2020. ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve, sikurse:

- Raportimi i Auditorit te Brendshëm ne lidhje me gjetjet e auditimit të fundit dhe rekomandimet,

- Raportimi i Menaxherit te Departamentit për marrëdhëniet me Konsumatorë në lidhje me gjetjet,
- Raportimi i ZKF ne lidhje me 6 mujorin e parë, draft pasqyrat financiare të gjysmë vjetorit të vitit 2020,
- Diskutimet ne lidhje me auditimet e ardhshme të NjAB, si dhe
- Çështje të ndryshme.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave, Komisioni i Auditimit ka vlerësuar punën e auditorit të brendshëm, duke e konsideruar si vlerë e shtuar e kompanisë, gjithashtu ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Nga Komisioni i Auditimit u vlerësua raporti i auditimit për procesin e llogarive të arkëtueshme–borxheve të konsumatorëve, të prezantuar nga Auditori i Brendshëm, si raport gjithëpërfshirës dhe në përputhje me kërkesat e Komisionit të Auditimit.
- K.A kërkoi nga menaxheri për konsumator komentet lidhur me te gjeturat e Auditorit te Brendshëm në raport te auditimit te llogarive te arkëtueshmeve. Ndër të tjera rekomandimet e dhëna ju shtynë të përmirësoni dhe te i rritni të hyrat e kompanisë.
- K.A rekomandoi menaxherin për konsumator që të bëhen marrëveshje tri paleshe (konsumator, kompani dhe banka) për pagesë të borxhit me këste përmes bankave. (Konsumatorët për mundësin e pagesës së borxhit me marrëveshje përmes bankave të njoftohen me marketing te kompanisë nëpër rrjetet sociale, ueb faqe te kompanisë duke i ftuar dhe mundësuar pagesën e borxhit më këste).
- K.A rekomandoi Zyrtarin Kryesor Financiar që për takimin e Bordit te Drejtoreve në paraqitjen e pasqyrave financiare për gjashtë mujorin e parë 2020 të përfshihet edhe rivlerësimi i aseteve te Kompanisë si dhe detyrimet e kompanisë ndaj Kek-ut dhe ATK.
- K.A tha të vazhdohet me auditim nga Auditori i brendshëm ne sektorin e prokurimit, dhe t'i dërgohet Komisionit te Auditimi draft raporti auditimit lidhur me menaxhimin e procesit te tatimit në të ardhurat personale dhe kontributeve pensionale.

05. Takimi i pestë i Komisionit të Auditimit, në përbërje të Edmond Hoxha- Kryesues i Komisionit të Auditimit, Agron Shala- anëtar i Komisionit të Auditimit dhe Mirzet Dzigovic-anëtar i Komisionit, është mbajtur me datë 01.09.2020. ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve, sikurse:

- Shqyrtimi i te gjeturave nga raporti auditimit nga ZKA,
- Shqyrtimi i të gjitha obligimeve ndaj ndërmarrjeve tjera publike, institucioneve shtetërore si dhe operatoreve ekonomik,
- shqyrtimi i planit vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, si dhe çështje të tjera,

Pas shqyrtimit të këtyre pikave, Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- K.A rekomandoi menaxhmentin e kompanisë që rivlerësimi i aseteve te kompanisë të regjistrohet në sistem të kompanisë ne pajtim standardet.
- Me plan të veprimit lidhur me implementimin e te gjeturave, të jenë përgjigjet për çdo të gjetur si do te realizohet dhe kohën që do të realizohet e gjetura.

- K.A rekomandoi që të implementohet të gjitha të gjeturat në raportin e ZKA për vitin 2019 sipas planit të veprimit të përgatitur nga shërbimi i financave në bashkëpunim me menaxhmentin e kompanisë.

- K.A kërkoj nga Auditori i brendshëm të hetoj rrjedhën e dokumenteve prej protokollit të shpërndarja në shërbimet përkatëse.

-K.A kërkoj nga menaxheri i projektit të ITUZ, të gjitha marrëveshjet e pagesave të projektit të ndërtimit të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza duke përfshirë edhe te papriturat e projektit.

- K.A vlerësoi që të vazhdohet auditimi nga auditori i brendshëm i kompanisë sipas planit vjetor të punës 2020 me auditimin shtesë të protokollit të kompanisë.

06. Takimi i gjashtë dhe i fundit i Komisionit të Auditimit për vitin 2020, në përbërje të Edmond Hoxha- Kryesues i Komisionit të Auditimit, Agron Shala- anëtar i K.A dhe Mirzet Dzogovic-anëtar i K.A është mbajtur me datë 02.10.2020, ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve, sikurse:

- Shqyrtimi i Draft raportit të auditimit lidhur me procesin e arkivimit,
- Zbatimi i auditimeve të planifikuara për vitin 2020.
- Shqyrtimi i raportit të Arkëtimeve dhe Shpenzimeve të muajit gusht.
- Të ndryshme.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave, Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- K.A aprovoi raportin final të Auditorit të Brendshëm lidhur me menaxhimin e procesit të arkivimit të lëndëve.
- K.A rekomandoi menaxhmentin e Kompanisë që filloj të punoj rregulloren për administrimin e procesit të arkivimit të lëndëve, në rregullore të përfshihet edhe procesi i dhënies së pëlqimeve, forma se pas sa kohe mundën të barten dokumentet në arkiv të qytetit si dhe të parashihet një sistem i personave se kush ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike.
- K.A kërkoj nga shërbimi me konsumator raport si azhurnohen të dhënat e adresave të konsumatorëve apo procesi si përditësohen informatat e konsumatorëve në kompani, ky raport të përgatitet për takim të radhës së Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve.
- K.A pajtohet me raportin përmbledhës të paraqitur nga Auditori i Brendshëm për 7 auditimet e realizuara, duke e vlerësuar punën e bërë nga AB në këto raporte.
- Kërkesa e K.A ndaj Menaxherit teknik ishte që çdo marrëveshje e projektit të ITUZ të protokollohet dhe një dosje komplet të dërgohet edhe një herë të UD. Kryeshefi Ekzekutiv.

2.3 Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividenden

Nuk ka pasë pagesa në emër të dividendes

2.4 Kredit e rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit 2020

Kredit afatshkurta nga viti 2018 e të bartura në vitin 2019 janë 35.489,00€
Kredi në vitin 2020 – 18.760,00€

2.5 Investimet gjatë vitit 2020

TOTAL INVESTIMET - 2020

NR	INVESTITORI	SHUMA- €
1	KRU, H.JUGOR" SH.A	360,445.81 €
2	K.K- PRIZREN	159,428.19 €
3	K.K- Suharekë	25,343.71 €
4	Donatoret-KFW	2,302,838.21 €
5	Vlera e investimeve te regjistruara	2,848,055.92 €
6	Vlera e investimeve ne vijim	417,442.63
7	TOTAL	3,265,498.55 €

INVESTIMET NË VIJIM

Data	projekti	nr.fatures	Furnitori	Qeveria
27.05.20	Impianti UZ	19.346-17	p2mberlin	114,083.58
17.09.20	Impianti UZ	20.072-19	p2mberlin	108,471.13
21.09.20	Impianti UZ	19.382-18	p2mberlin	106,937.05
01.12.20	Impianti UZ	Airks37/20	Aqualia	65,749.64
22.12.20	Impianti UZ	Airks39/20	Aqualia	22,201.23
				417,442.63 €

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI TEKNIK

3.1.2 SITUATA E FURNIZIMIT – JANAR – DHJETOR 2020

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania ka arritur që në muajt Janar-Dhjetor të vitit 2020 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në dite. Duhet theksuar se në muajin Janar-Dhjetor në disa pjese rurale në nivel regional kemi keqpërdorime enorme të ujit të pijes, prandaj dhe kemi planifikuar restreksione në disa fshatra në nivel regional. Për me gjëresisht janë prezente tabelat e reduktimeve nga njesite operuese të cilen mund ta gjeni në njesite perkatese.

Në njësitë tjera operuese si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjeset urbane, mirpo duke u bazuar në raportet e njesive operuese për shkak të keqpërdorimeve kemi aplikuar reduktime të planifikuara si dhe në varesi të defekteve të mundshme dhe ndërprerjeve të energjisë elektrike nga KEDS kemi ndërprerje të furnizimit me ujë të pijes *(për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njesive Operative nga udheheqsit e Njesive)*.

Vlen të ceket se në muajt Janar-Dhjetor në nivel regional kemi patur ndërprerje të ujit për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, prandaj si Departament Teknik sygjerojmë që furnizimi me energji elektrike të jetë prioritet nga ana e KEDS-it.

Në muajt Janar-Dhjetor në përgjithësi kemi patur furnizim të rregullt me ujë të pijes dhe aktivitete të duhura në mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, furnizimi me ujë të pijes ka qenë 24 ore/dite, duke garantuar shtypjen e nevojshme dhe cilësi të ujit 100%.

3.1.3 AKTIVITETET KRYESORE JANAR-DHJETOR 2020

* Takime të rregullta ditore me UD-Kryeshefin Ekzekutiv, në lidhje me mbarevajtjen e furnizimit me ujë të pijës, planifikimet, problemet ditore dhe rezultatet e aktiviteteve të ndermarra.

* Që nga data: 15.03.2020, departamenti teknik ka veperuar konform vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila për shkak të Pandesmisë me COVID-19, ka shpall emergjencë në Shendetin Publik ndërsa nga muaji Maj Sherbimi Teknik është duke punuar me staf të plotë.

* Takim i vecant me Konsulencën - p2m.dhe me kontraktorin.

* Takime të rregullta javore në Impiant.

* Korrespondencat per Fazen V te projektit CCTV, dokumentcioni i tenderit dhe komplet projekti per fazen V dhe VI i eshte dorezuar Aranit Ukimeri, i cili se bashku me ekipen e sherbimit teknik do ta menaxhoj kete projekt.

* Takim me Bordin e drejtoresve, ku sipas rendit te dites kam raportuar mbi ecurine , kronologjine dhe progresin e puneve ne ITUZ.

* Mbikqyrje e progresit te punimeve neper projektet te cilat jane duke u realizuar se bashku me orgnaet mbikqyrese te percaktuara me vendimet perkatese.

* Takime nga distanca permes aplikacionit ZOOM me perfaqesues te Konsulences P2m, ne lidhje me mbarevajtjen e projektit te ujerave te zeza ne Prizren.

* Eshte bere testimi i Kamionit-Cisternes se kombinuar per thithje dhe shtytje e cila eshte e dedikuar per pastrimin e kaperderdhesve dhe kanalizimievee furnizuar nga kontraktori TIMAK nga Shqiperia dhe implementuar nga Faza 1e projektit te ujerave te zeza per qytetin e Prizreni te financuar nga KfW. Me kete rast eshte verejtur se per sa i perket pjeses shtytese, kamioni nuk i permbushte kerkesat tona edhe pse eshte furnizuar konform kerkesave ne kontrate, ne menjehere kemi kerkuar qe te rritet kapaciteti i pompes ne menyre qe te rritet presioni dhe te mundesohet funksionimi sa me i mire i pjeses shtytese. Timak bashk me konsulencen P2m menjehere pas kerkeses sone kan ndermarr aktivitetet dhe e kan ndrruar pompmen ku nga nga 15l/min. qe ishte ata kan instaluar pompen e re ne 75l/minut, pas testimit me pompen e re u verejt se presioni u rrit ne mas te duhur mirpo pa mundesi pastrimi per gypat mbi DN 200mm, mirpo nese i referohemi cmimit te blerjes dhe mjeteve te percaktuara paraprakisht nga kfW per kete sherbim, konsulenca na tregoj se eshte e mjaftueshme dhe se cisternat me presion shume te larte kushtojne sa dy fishi i mjeteve qe jane parapare per kete sherbim.

* Eshte kerkuar miratimi nga KfWper pranimin teknik te cisternes shtytese-thithese te furnizuar nga TIMAK, KfW ka miratuar pranimin teknik sipas kerkesave te pershkruara ne kontraten ne mes te HRJ-se dhe TIMAK.

* Per sa i perket cisternes shtytese-thithese te furnizuar nga TIMAK, ne jemi duke analizuar se a ka mundesi teknike qe te rritet fuqia e ppompes shtytese, te rritet dimensionimi i gypit shtytes si dhe te komunikojne ent ne mes vete, ne menyre qe pjesa shtytese me presion te kete performance me te mire per pastrimin e kanalizimit, jemi ende duke diskutuar me kompanine konsulente.

* Korrespondencat ne mes HRJ-së, Timakut dhe konsulences, per permiresimin e performancës teknike të cisternes thithese-shtytese, jemi ne pritje qe TIMAK te na ofroje pjesen financiar te ndryshimeve te kerkuara, pasi qe teknikisht nje gje e till eshte e mundur.

* Edhe gjate muajve Korrik-Gusht kemi bere inspektimin e furnizimit me ujë të pijes për fshatin SHKOZE, me crast dhe kemi perpiluar raportet e të gjeturave dhe kemi hartuar planin e veprimit se cfar duhet të bëjmë me këtë fshat. Gjatë inspektimit të pare me ekipet e brendshne të inspektoriatit janë konstatuar disa parregullsi tek konsumatorët e këtij fshati dhe sipas informatave qe kam nga sherbimet perkatese, këto keqpërdorime janë proceduar sipas rregulloreve të kompanisë. Gjatë këtij muaji furnizimi në këtë fshat ka qenë i rregullt nuk kemi pas ndonje ankese për mungese të furnizimit. Në hapat e ardheshem sipas planit të veprimit është parapare që së bashku me inspektoriatin e kompanisë dhe ekipet teknike të bëhet inspektimi i dyte i konsumatoreve në këtë fshat, mirpo kjo do të realizohet pasi qe kompania kontraktuese të vendos klorinatorin në gypin furnizues që e furnizon këtë fshat. Edhe gjatë këtij

muaji kontraktori nuk e ka vendosur pikën klorifikuese për këtë fshat. Situata e furnizimit në fshatin Shkoze aktualisht është e kenaqshme.

* Vizita në fshatin Zhur, me qëllimin e verifikimit të sasisë së ujit që furnizon këta banorë, në konstatim se nga rezervoari i fshatit Zhur dalin me së paku 25-27 l/s, sasi kjo e mjaftueshme edhe për tre fshatra me madhësi të Zhurit, nga kjo vizite konkludohet se ndërohet kthina e cila do të sigurojë njëzet kryesore të furnizimit-valvulat komanduese për secilin lagje, dhe të rritet angazhimi i punëtorëve të ujësjellesit të cilët janë përgjegjës për fshatin Zhur.

* Në muajin Tetor kemi pasur rënje të ujit burimit tek stacioni i pompave në Vërmice, në koordinim me Menaxhmentin e kompanisë, kemi planifikuar që të ndërhyjmë në kaptazhën e burimeve të Vërmicës në aspektin e rehabilitimit në mënyrë që të shtohet sasia e ujit tek stacioni i pompave, poashtu kemi propozuar projektin e vendosjes së ujëmatësve të konsumatorëve në prona publike, gjë që direkt ndërlidhet me zvogelimin e humbjeve të ujit dhe na mundëson furnizim të rregullt me ujë të pijës për të gjitha fshatrat që furnizohen nga burimi i stacionit të pompave në Vërmicë.

* Sa i përket Komunes së Mamushës, kemi ngecur për shkak të situatës me COVID-19, megjithatë unë kam qenë disa herë në kontakt me kryetarin e Mamushës, dhe me të njëjtin kemi dakorduar që të marrim masat e duhura që sa më shpejtë ta funksionalizojmë Mamushën për sa i përket furnizimit me ujë të pijës, konkretisht kryetari e ka marrë përsipër riparimin-suvatimin e jashtëm të kthinës ku do të instalohen paisjet për klorifikim, në disa here kemi testuar ujin nga pusi i ri i dedikuar për furnizim të Mamushës dhe kemi në pritje të zhvillimit të aktiviteteve për vazhdimin e vendosjes së ujëmatësve tek konsumatorët të cilët duan të furnizohen nga HRJ.

Vlen të ceket se komuna e Mamushës është me specifike si në aspektin teknik të furnizimit po ashtu edhe në aspektin e konsumatorëve, sepse rreth 80% e konsumatorëve kanë puse private dhe aktualisht furnizohen nga këto puse si dhe rreth 50% e konsumatorëve që i kemi vizituar nuk kanë dashtë të kyçen në ujësjellësin e HRJ-se.

* Vizite në Komunën e Mamushës dhe biseda telefonike me Kryetarin e Komunës së Mamushës, me rast dhe po të njëjten ditë kryetari angazhohet një punëkryes i cili në prezencën time dhe të Lumit u identifikuan pozicionet të cilat duhet renovuar dhe punëkryesi i angazhuar nga kryetari bëri matjet e duhura për të përpiluar paramasën dhe paralogarinë.

* Dorezimi i paramasës dhe paralogarisë nga Komuna e Mamushës për renovimin e pikës klorifikuese në Mamushë.

* Takime, korrespondenca me email, dhe biseda telefonike me përfaqësuesit Komunal, konkretisht me kryetarin e Komunes, stafin e tij dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike, me temën mundësia e realizimit të buxhetit lokal me të cilin është urgjente që të paguhet angazhimet e konsulentëve sipas kontratës dhe komuna është zotuar përmes letrës së angazhimit, përmes minutave të takimit të zhvilluar në mes paleve e sidomos me marrëveshjen e vecantë e cila e obligon komunën që me kërkesën e KfW, komuna është e obliguar të transferojë mjete financiare në llogarinë vecantë tek Hidroregjioni Jugor.

* Edhe në këto muaj kemi patur takime, korrespondenca me email, dhe biseda telefonike me përfaqësuesit Komunal, konkretisht me kryetarin e Komunës, temat kryesore gjatë këtyre takimeve kanë qenë projekti i ITUZ-se dhe implementimi i fondeve të cilat Komuna e Prizrenit i ka ndarë për ujë në vitin 2020.

* Komuna e Prizrenit i ka kthyer leter KfW-se per sa i perket transforimot te mjeteve financiare ne llogarine e vecant tek HRJ, sipas meje si kryetar i komitetit te ketij projekti, letra e kthyer nga Komuna e Prizrenit nuk ishte ne nivelin e duhur te komunikimit me KfW-ne. Une menjehere kam shkruar letër tek KfW duke ju referuar letrës së Komunës, ku dhe kam sqaruar në detaje përfaqesuesit e KfW-se, të njejtit me janë përgjigjur se do të shkruajn letër përseri në Komunë dhe do ta sqarojnë sa me detalisht se këto mjete financiare duhet pa tjetër të transferohen tek HRJ, sepse janë të zotuar nga Komuna përmes marreveshjeve ligjore.

* Sipas informatave të fundit stafi i huaj i konsuleces dhe kontraktorit do të jenë prezent në Prizren me rastin e liritimit të kufijve tokesor dhe ajror me Evropën. Me rastin e ardhjes së stafit në si kompani dhe përfitues i projektit duhet ta kemi të konsoliduar stafin e ITUZ-se dhe duhet të jetë i gatshëm që të filloj me trajnimet e parapara sipas programit të trajnimeve.

* Sa per informimin tuaj ne muajin dhjetor jane zhvilluar aktivitete ne trajnimin e stafit dhe a perfunduar pjesa e testimi 72 oresh ne ITUZ, aktivitetet ne lidhje me komisionimet dhe testet jane te pershkrura ne raport te vecant te perpiluar nga mbikqyrja e konsulences.

* Përseri gjatë muajve Korrik-Gusht, së bashku me konsulencën kemi derguar letër tek kontraktori AQUALIA, që të vazhdoje aktivitetet me parakomisionimin dhe komisionimin e ITUZ-se, përseri e njejtja na është përgjigjur duke ju referuar përkeqesimit të situatës me COVID-19 koheve të fundit në Kosovë. Aktualisht për sa i përket stafit të huaj, jemi në funksion të situatës me COVID-19.

* Edhe në muajt Korrik-Gusht, Kontraktori AQUALIA, nuk ka filluar me aktivitetet e parakomisionimit dhe komisionimit, po ashtu nuk ka pergaditur ende manualet te cilat nevojiten për trajnimin e stafit dhe operimit me ITUZ. Sipas Kontraktorit materialet janë duke u përgaditur. Përmes postës elektronike AQUALIA ka pohuar se në fillim të muajit Shtator do të fillojë me aktivitetet e parakomisionimit dhe komisionimit

* Takim virtual me konsulencën P2m, kontraktorin AQUALIA dhe konsulencën e Masave shoqeruese, me temën zhvillimi i aktivitetëve në trajnimin e stafit të ITUZ-se.

* Mungesa e menaxherit të komisionimit në vend, ku dhe diskutuam në lidhje me teknikun e kualifikuar për të rifilluar punimet të Mërkurën javën e ardhshme me datë: 11.11.2020 i cili do ta zëvendësojë teknikun që ishte i sëmure dhe kishte udhëtuar për Spanjë, i njejtë kishte ardhur në fillim të Shtatorit për aktivitetet e parakomisionimit.

* Përgaditja e dokumentacionit për SDSW Kosovo Ph2 - IPC 39, ku kërkova nga KfW, miratimin e kësaj pagese për AQUALIAN, kjo pagese është egzekutuar nga llogaria e vecant e projektit.

* Kontrollimi dhe verifikimi i pagesës IPCnr.39, për AQUALIA,

* Shqyrtimi dhe aranzhimi i kërkesës për takim që KfW kishte kërkuar për takimin vjetor me temën Progresi i projekteve të financuara nga KfW.

* Procedimi dhe rikontrollimi i VO-4.0 dhe 4.1, që ka të bëjë me penstock-porten lëshuese tek puseta kryesore e cila lëshon/ndalon ujërat e zeza që të futen në linjen paratrajtuese si dhe ngritja e nivelit të disa pusetave pasi që tek kjo pike ndërthuren Faza 1 dhe Faza 2 e projektit. Pajesa e VO4 dhe 4.1 është egzekutuar nga llogaria e vecant e projektit.

* Korespondenca me inxhinierin e konsulencës për koordinimin dhe harmonizimin e agjendjes në lidhje me takimin virtual me KfW-ne.

* Sqarimi sipas kërkesës se KfW-se në lidhje me situatën teknike dhe financiare të Fazës 2 të projektit ITUZ, ku përmes shkresës zyrtare e njoftofa znj. Dulleknopf për:

- Progresin e punimeve,

- Situaten aktuale të pagesave për Konsulencen dhe Kontraktorin,
- Progresin në lidhje me buxhetin local të cilin Komuna e Prizrenit do ta transferonte në konton e vecant te projektit.

* Plotesimi i pyetesorit të dërguar nga KfW për takimin virtual me temen Progresi i projekteve të financuara nga KfW.

* Dergimi i Raportit Periodik nr. 68 nga Konsulenca P2m Berlin, i cili përfshin aktivitetet për muajin Nëntor 2020, raport i cili është përkthyer dhe është analizuar nga ana jonë.

* Koordinimi me të dy konsulencat dhe kontraktorin e projektit të ITUZ-se në lidhje me takimin virtual me KfW.

* Takim virtual me KfW-në, ku u diskutuan pikat sipas rendit të ditës dhe pyetesorit të dërguar nga KfW, e në vecanti u diskutua për progresin e punimeve në ITUZ dhe gjendjen financiare të projektit si dhe kompletimin e stafit i cili do të operoj me ITUZ-në, dhe në fund u nxjerren këto konkluzione dhe detyra:

Konsulenca P2M Berlin:

- Azhurimi i orarit të komisionimit,
- Azhurimi i orarit të trajnimeve,
- Përditesimi i raporteve për datën e përfundimit të projektit ose certifikaten e përkoheshme të pranimit Teknik,
- Përditesimi i pageave dhe buxhetit të nevojshem për ta përfunduar plotesisht projektin,

KRU"HRJ"Sh.A, Prizren

- Pagesa e IPC nr. 38, dergimi në KfW për pagese,
- Pagesa e IPC nr.39, kompletimi dhe përfundimi i pagesës,
- VO 4.0 dhe 4.1, dergimi formal për miratim në KfW dhe pagesa e faturës,
- Shqyrtimi i Addendum nr.7 nga HRJ dhe dërgimi për miratim në KfW,
- Kompletimi i stafit, kryesisht të pjesa e operimit Elektromekaniket,
- Buxheti local i Komunës i cili do të transferohet në konton e vecant të projektit,
- Takim me përfaqesuesit e Komunës dhe MMPH-së për azhurimin e lsites së ndotësve industrial, etj.
- Të gjitha këto konkluzione-detyra do të rishikohen në takimin virtual të radhës të cilin do ta mbajmë me KfW me datë: 09.12.2020 në orën 10:00 ne zyret e HRJ-së.

* Takimi dyte virtual me KfW-ne, konsulencat e projektit dhe kontraktorin e fazes 2, teme e ketije takimi ishte implementimi i i qeshtjeve te cilat u zotuan ne takimin virtual te mujait te kaluar si:

- Pagesat e IPC nr.38 dhe 39-(e realizuar)
- Pagesa e VO 4 dhe 4.1-(e realizuar),
- Addendun 7 nga P2m Berlin, (pas kontrollit nga ana jone u kthye ne rishqyrtim)
- kompletimi i stafit, (jemi ne procedure)
- Buxheti lokal, (jemi ne procdure)
- Nderprerja e energjise elektike dhe leknudjet e tensionit (paragraf i vecant sqarues),
- Ujerat industriale, (u zhvillua takim virtual (telefon) me inspektoriatin e MMPH-se).

* Dërgimi i VO-4.0 dhe 4.1 për miratim në KfW.

* Miratimi nga KfW për VO-4.0 dhe 4.1, përgaditja e dokumentacionit nga konsulenca, jemi në pritje të faturës në menyre që të procedojm pagesen nga kontoja e vecant.

- * Takime virtual me inxhinierin e konsulences permes platforms WHAT's UP, në lidhje me progresin e punimeve për Fazës 2.
- * Takime në vendpunishte dhe takime në zyret respective me konsulencen vendore, konkretisht me inxhinierin e konsulences vendore Alb Architect.
- * Takim me kompanine vendore te fazes 5 dhe 6 me temen mundesia e pastrimit te kaperderdhesve ne aspektin e funksionimit.
- * Takim sqarues me inspektoriatin e Komunës për pikat shkarkuese tek Theranda dhe parking i Komunës.
- * Takim me Drejtoreshën e Financave të Komunës për kontributin local të projektit të ITUZ-së.
- * Analizimi i kontratës në mes të HRJ-së dhe Komunës për projektin “Vendosja e pusetave dhe ujëmatësve në pronë publike për konsumatorët e fshatrave të burmit të Vërmicës - Prizren, duke përfshirë fshatrat Zhur, Shkoz, Vërmicë dhe Dobrusht”.
- * Bisede telefonike me Shefen e kryetarit te Komunës Krenare Koçi, ne lidhje me kontributin local per projektin e ITUZ-se.
- * Takim me z. Ibrahim Gjylderren me temen vlerësimin e ndikimit financiar të Covid-19 i inicuar dhe investuar nga BERZH-i. Ky takim kishte të bënte me ndikimin e pandemisë në të hyrat, shpenzimet dhe kapacitetin e ndërmarrjes që të vetfinancoj projektet kapitale për 2020 dhe vitet pasuese.
- * Takim me z. Lum Nita dhe znj. Nida Krasniqi në Ministrine e Financave Departamenti i projekteve të investuara nga agjencionet e jashtme financiare, në lidhje me Kontributin local të komunes se Prizrenit të cilin Komuna e Prizrenit sipas marrveshjes së vecant është e obliguar ta transferoj në konton e vecant të projektit tek HRJ.
- * Njëkohësisht si kopije e forte u dorezua në arkiven e thesarit edhe kërkesa për zbatimin e Marreveshjes së veçante nga ana e Komunes së Prizrenit, po ashtu kjo kërkesë ju është dërguar në forme elektronike edhe parfaqesuesve të Komunës së Prizrenit.
- * Kontaktimi i kompanisë punëkryese sipas kërkesës së Njesisë Punuese në Malishevë për në pastrimin e Pusin nr. 1 në fshatin Senik.
- * Paramasat dhe Paralogarite për pozicionet, SOZI, Muri vazhdues në 40-Burime, Puseta e valvulave në Zhur dhe Shkolla me nevoja të vecanta.
- * Takim sqarues me inspektoriatin e Komunës për pikat shkarkuese tek Theranda dhe parking i Komunës.
- * Rishikimi dhe analizimi i buxhetit të MMPH-së, Komunës dhe KfW-së për Projektin e Ujërave të Zeza në qytetin e Prizrenit, Faza1 dhe 2 (Pune në shtepi).
- * Dërgimi i Fiche Projekteve për ujëra tek Adem Ahmetaj sipas kërkesës së Ministrise së Financave.
- * Përditesimi-Azhurimi i gjatësisë së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ridërgimi në ARRU sipas kërkesës së ARRU-së.
- * Ftesa nga SHUKALB për pjesëmarrje në cilesine e moderatorit për projektin e RCDN-së me temen shkembimi i përvojave me koleget për implementimin e projekteve në sistemin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- * Takim virtual me SHUKALB ne cilesine e moderatorit n lidhje me aktivitetet trajnuese per zhvillimin e projekteve te ITUN-ve, takim virtual 4 ditor.
- * Përgjigje nga Thesari në lidhje me kërkesën e datës: 05.11.2020, me crast i njoftova të gjitha palet në lidhje me këtë përgjigje.

* Bisede telefonike me Drejtoreshen e Financave të Komunës për kontributin local të projektit të ITUZ-së, e njejtua u njoftua përmes telefonit dhe emailit për përgjigjen negative që e kemi marr nga Thesari.

* Pjesëmarrje në Takimin e Menaxhmentit.

* Per sa i perket ceshtjeve se luhatjes e tensionit dhe nderprerjes se energjise elektike ne ITUN e cila eventuaisht mund te paraqes pengesa ne aktivitetet testuese per kontraktorin, ne si HRJ i kemi derguar te dhenat nga data baza e KEDS-it edhe tek konsulenca edhe tek kontraktori, te njejtat jane duke u shiqyrtuar nga palet dhe do te reflektohet ne pretendimin nr.16 te pretnuar nga kontraktori, perndyshe ne si klient duhet te sigurohemi ne menyre rigoroze nga konsulenca dhe kontraktori qe kjo qeshtje te rregullohet fillimisht ne aspektin teknik po ashtu edhe ne ate adminitrativ, perndryhe ne emer kryetarit dhe anetarit te komitetit te projektit kembengul qe as ne si klient as konsulenca e projektit te mos e leshoje certifikaten e pranimit teknik per asnje pjese te projektit pa u siguruar qe te gjitha paisjet elektromekanike te sigruojne tension adekuat ne menyre qe edhe ne vitet e ardhshme te mos kemi probleme ne aspektin e operimit me ITUN.

* Komuna e Prizrenit i ka kthyer letër KfW-së për sa i përket transformot të mjeteve financiare në llogarine e vecant tek HRJ, sipas meje si kryetar i komitetit të këtij projekti, letra e kthyer nga Komuna e Prizrenit nuk ishte në nivelin e duhur të komunikimit me KfW-ne. Unë menjëhere kam shkruar letër tek KfW duke ju referuar letrës së Komunës, ku dhe kam sqaruar në detaje përfaqesuesit e KfW-se, të njejtit me janë përgjigjur se do të shkruajn letër përseri në Komunë dhe do ta sqarojne sa me detalisht se këto mjete financiare duhet pa tjetër të transferohen tek HRJ, sepse janë të zotuar nga Komuna përmes marreveshjeve ligjore.

* Në fillim të muajit Shtator ka ardh nje ekspert nga AQUALIA dhe kanë filluar fillimisht me aktivitetet e parakomisionimi, pas ketyre aktiviteve do te fillohet me aktivitetet e komisionimit dhe sipas planit të parapare planifikohet që ITUZ të lëshohet në operim në muajin Janar 2021.

* Projektet e financuara nge Qeveria Zviceriane dhe nga KfW jane duke u implementuar, edhe përkunder veshtiresive me situaten me COVID-19, raportet perkatese janë proceduar nga Menaxheret e ketyre projekteve si Lulzim Paçarizi, Zenel Zenelaj dhe Aranit Ukimeri.

* Sa i përket projektit te Ujerave te Zeza, konkretisht Fazes 1 dhe Fazes 2 te projektit, ju njoftoj se Faza 1 e projektit që ka të bëjë me Ndërtimin e kolektorit në anen e majtë të Lumbardhit, ka përfunduar komplet, tani jemi në fazën e përgaditjes përfundimtare të dokumentacionit të cilin do ta dorezojmë në arkive dhe në shërbimin për kontabilitet në menyre që të regjistrohet si aset i Kompanisë, kurse sa i përket Fazës 2 të projektit, tani me jemi në fazën përfundimtare dhe ITUZ ka filluar operimin ne aspektin e testeve te nevojshme.

Për më tepër kemi në dispozicion Raportet Mujore dhe Tremujore si dhe për çdo gjë tjetër mund ta kontaktoni Kryetarin e Komitetit të këtij projekti Lulzim Paçarizi dhe Anetarin e këtij komiteti Lumni Sallahun (nuk ka ndonje ndryshim te theksuar ne lidhje me progresin e punimeve per Fazen 2).

* Vlen te ceket se sebashku me UD Kryeshef Ekzekutiv kemi kontaktuar dhe jemi takuar disa here me Kryetarin e Komuns z. Haskuka si dhe me stafin e kryetarit dhe me Drejtorin e sherbimeve publike, per kontributin vendor te cilin e ka per siper komuna permes mrreveshjes se vecant. Edhe pse banka gjermane per zhvillim KfW ka derguar leter te komuna e Prizrenit, konkretisht tek kryetari i komunes dhe ka kerkuar qe fondet sipas marreveshjes te transferohen

ne konton e vecant te projektit, mirpo Komuna e Prizrenit ende nuk kakthyr ndonje pergjigje. Une si kryetar i komitetit te ketije projekti shpreh shqetsimin tim ne lidhje me neglizhencen qe Komuna e Prizrenit e ka ne raport me KfW-ne si financuese e shume projekteve ne Kompanine tone.

* Me theks të vecant do të raportoj për ceshtjen e obligimeve kontraktuale të cilat i kemi ndaj Konsulences P2m Berlin, e njejta na ka paralajmerur se nëse nuk do të egzekutohen pagesat brenda një kohe të shkurter, është e mundur që ta ndërpresin kontraten me ne dhe për një gjë të tille kanë të drejte sepse është e percaktuar në rregulloret e Fidic mbi të cilat është duke u realizuar projekti. Për këtë ceshtje janë lajmruar UD Kryeshefi Ekzekutiv si dhe Menaxheri Financiar. Për këtë ceshtje kam propozuar që këto obligime kontraktuale është e mundur të paguhen nga Kontoja e vecant e projektit dhe për këtë kam marr miratimin edhe nga KfW.

* Sa i përket projektit Masat Shoqeruese, ne si klient i kemi dhene miratimin per fillimin e fazes 2 e cila parasheh mbikqyrjen edhe per 18 muaj ne aspektin e trajnimit dhe operimit me ITUN. Aktualisht kompania DORSCH, eshte duke e shqyrtuar programin e trajnimeve te stafit dhe eshte ne komunikim me kompanine konsulente dhe ate kontraktuese me te vetmin qellim qe trajnimi i stafit te kryhet ne menyre sa me efikase.

* Sipas informatave te fundit stafi i huaj i konsuleces dhe kontraktorit do te jene prezent ne Prizren me rastin e lirimit te kufijve tokesor dhe ajror me Evropen. Me rastin e ardhjes se stafit ne si kompani dhe perfitues i projektit duhet ta kemi te konsoliduar stafin e ITUZ-se dhe duhet te jete i gatshem qe te filloj me trajnimet e parapara sipas programit te trajnimeve.

* Takime ditore dhe javore me udheheqesin për Planifikim dhe Zhvillim, Koordinatorin e sektoreve brenda Planifikim zhvillimit, në lidhje me aktivitetet në implemtimin e GIS-it, MMS-it MMA dhe zbatimit të strategjise për zvogelimin e humbjeve.

Aktivitetet e këtij sektori do ti gjeni të paraqitura me poshte në këtë raport.

* Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjeter të qytetit për eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajn ujin në menyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve në sherbime dhe investime për sherbim sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Prodhimi i ujit m³ - Janar-Dhjetor, 2020

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	11,635,488.00	31,878.05	369.0	
Suharekë	2,392,058.00	6,553.58	75.9	
Dragash	1,018,991.00	2,791.76	32.3	
Malishevë	1,473,695.00	4,037.52	46.7	
Total	16,520,232.00	45,260.91	523.9	

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2020

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1,548	555	2103
Suharekë	292	134	426
Dragash	54	18	72
Malishevë	564	274	838
Total	2458	981	3439

Zyra për planifikim dhe zhvillim – Janar - Dhjetor, 2020

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllombimet e ujëmatësive nëpër qytetin e Prizren-it, ku kanë arritur këto rezultate:

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	2741
2	Dera Mbyllur	4697
3	Pa ujëmatës	15
4	Ribllombim	2809
5	Duhet regjistruar	15
6	Kërkes nga konsumatori	63
7	Zevendesim	06
8	Regjistrim i ri	41
9	Aktivizim	14

AKTIVITETET KRYESORE

- * Përpilimi i raportit Janar-Dhjetor, 2020.
- * Takim pune në KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A me përfaqësuesit e ARRU-së (Zogë Spahiu, Albana Abazi dhe Arta Sylejmani).
- * Punime në funksionalizimi i rrjetit të Mamushës (riparime të defekteve).
- * Mbikqyrje në projektet e CDI-së në qytetin e Prizrenit dhe zonat rurale të Prizrenit.
- * Asistim në terren për vlersimin e aseteve të kompanisë.
- * Bllombimi i ujëmatësive të ri të montuar nga CDI në fshatin Mazrek ku kanë arritur që të bëjnë gjithsej: 103 bllombime të ujëmatësive të ri, 13 bllombime të ujëmatësive të vjetër si dhe 42 bllombime të ujëmatësive të kons. të ri që duhet regjistruar.
- * Punime në ndërrimin dhe instalimin e ujëmatësive në Mamushë ku kanë arritur këto rezultate: 17 instalime, 84 ndërrime, 83 nuk pranojnë, 17 teknikisht, 13 nuk kanë lidhje uji, 2 duhet instaluar, 8 lidhje uji nga kojshit, 1 e pabanushme dhe 6 dera mbyllur.
- * Inspektimi i punimeve nga ARRU-ja në Mamushë.
- * Dalja në terren e grupeve për evidentimin e konsumatoreve me faturim paushall puna ka filluar me 10.06.2019 dhe do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, poashtu edhe ndërrimi i

ujëmatësive të konsumatoreve të mëdhaj me ujëmatësia \varnothing 50mm deri \varnothing 150mm si dhe montimi i ujëmatësive në banesat kolektive në qytetin e Prizrenit.

* Takim pune në SHUKOS, "Standardet teknike për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujësjellesit".

* Matja gjeodezike e Rezervuarve dhe Stacioneve të Pompave për njësin e Prizrenit si dhe aktivitete të ndryshme profesionale (matje për nevoja të kompanisë).

* Mbikqyrje në projektin "Inspektimi me CCTV" nga KWE (sistemi i kanalizimit).

* Digjitalizimi i konsumatoreve në GIS për njësit e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.

* Vizita në teren në fshatrat: Zhur, Shkozë dhe Vermicë për furnizim me ujë (keqperdorim i ujit nga ana e qytetarve), kemi marr masa për vendosjen e ujëmatësive të furnizimit si dhe kontrollimin e vazhdueshëm të qytetareve.

* Regjistrimi (kontrata) dhe bllombimi i konsumatoreve në fshatin Landovicë: 153 kontrata dhe bllombime, 10 kons.nuk pranojnë, 50 kons. dera mbyllur dhe 1 defekt.

* Bllombimi i konsumatoreve në lagjen Janina (Gurishtë): 59 bllombime, 16 kontrata-bllombime, 2 puseta e mbyllur dhe 1 defekt.

* Bllombime në lagjen Dardania: 466 bllombime, 6 të pa banushme, 85 nuk kanë ujëmatës të ri, 21 regjistrim i ri, 1 në ndërtim dhe 13 dera mbyllur.

* Bllombimi i konsumatoreve nëpër fshatrat e Prizrenit: 43 kontrata-bllombime, 29 ribllombime, 02 duhet regjistruar, 02 aktivizime, 04 kërkesa nga konsumatorët, 04 regjistrime të reja dhe 40 dera mbyllur (nuk kemi pas qasje tek konsumatori).

* Ndririmi i ujëmatësive të konsumatorëve të mdhaj: Drejtoria e Financave (6/4), Enti për punësim (\varnothing 50 mm), Qendra Sportive (\varnothing 50 mm), Shtëpia e bardh (\varnothing 50 mm), G5 (Tjerrtorja, \varnothing 100 mm), G 5 (të Xhambo, \varnothing 100 mm), Valvisi Kompani (Abi Elif, \varnothing 150 mm) dhe Marif School (\varnothing 150 mm).

* Pjesëmarrje virtuale në Konferencën e Ujërave si PRU, të organizuar nga SHUKALB dhe SHUKOS në Tiranë.

* Pas përfundimit të projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit në fshatin Gjonaj" projekt i financuar nga K.K Prizren, KRU "HRJ" Sh.A ka vazhduar montimi i ujëmatësive tek konsumatorët.

* Gjatë muajt Janar-Dhjetor kemi vazhduar me përpunimin e të dhënave të terrenit, vendosjen e të dhënave në GIS.

Databaza e konfiguruar nga ana e Sherbimit Teknik dhe MMS-Tool çdo ditë bëhen backup dhe ruhen në serverin e Kompanisë dhe në një Hardisk të jashtëm për rast sigurie.

Në bashkëpunim me CDI është duke u punuar një aplikacion i cili do të mundësojë që kujdestarët e stacioneve të pompave dhe përgjegjësëve të fshatrave të mund të raportojnë për defektet përmes telefonit të mençur, ku si pasojë e kësaj kemi filluar që të mbledhim të dhënat dhe këto të dhëna të strukturohen në mënyrë që të kemi qasje me të lehtë dhe komunikim me c' rast departamenti i Gis-it do të jetë kompetent për ruajtjen dhe strukturimin e këtyre të dhënave.

Këto të dhëna do të strukturohen në databazën e konfiguruar në serverin e kompanisë ku secilit përdorues të GIS-it do të ju është mundësuar qasja në databazë si dhe në hapësirën punuese QGIS.

* Verifikimi i konsumatoreve në hartë, regjistrimi i të dhënave (kons.emri dhe mbiemri), regjistrimi i rekordeve që nuk kanë numër të rekordeve në hartë, futja e shënimeve në rekorde të reja (kons.emri dhe mbiemri) si dhe lidhja e rekordeve Navizhen – GIS.

* Në muajt Janar-Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kane arritur qe gjithsej të demontojnë dhe montojnë 728 ujëmatësas dhe të instalojnë 8 ujëmatësas, poashtu ne muajin Mars është marrë vetëm me rastet specifike (xhami i thyer), ekzistojnë raporte mujore të veçanta.

* Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Janar- Dhjetor, ka bërë gjithësej 569 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 368 defekte kurse ne muajin Mars është marrë vetëm me rastet specifike (operativa), ekzistojnë raporte mujore të veçanta. Poashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 24,777m.

* Leximi i ujëmatësave zonal për muajt Janar-Dhjetor, ujëmatësasat në pikat matëse: Fehmi Lladroci, të ETC-ja, Gorozhup dhe Landovicë ska lexim, Të KFORI, Jusuf Gervalla dhe Atmaxhë lexim të ulët të ujëmatësave (Atmaxhë baypass), Kobaj, Nashec i epërm, Tupec dhe Grazhdanik pusetat me ujë, Gjonaj i poshtem dhe Gjonaj i epërm ujëmatësasat e demtuar (koka e ujëmatësasit). Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këtë muaj.

* Poashtu në muajt Janar-Dhjetor kemi pasur dy raste për riparimin e ujëmatësave që janë sjell nga vet konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: Janar - Dhjetor, 2020

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve Φ (13-100)mm.

Njësia Operative Profili / Φ mm sasia / copë		Njësia Operative Profili / Φ mm sasia / copë		Njësia Operative Profili / Φ mm sasia / copë		Njësia Operative Profili / Φ mm sasia / copë					
Prizren	1/2"	202	Suharekë	1/2"	0	Malishevë	1/2"	15	Dragash	1/2"	21
	3/4"	436		3/4"	0		3/4"	78		3/4"	43
	1"	40		1"	0		1"	1		1"	2
	5/4"	5		5/4"	0		5/4"	0		5/4"	0
	6/4"	2		6/4"	0		6/4"	0		6/4"	0
Total		685	Total		0	Total		94	Total		66
Totali i servisimit të ujëmatësave në nivel regional KRU"HRJ"-Prizren										845	
Leximi i ujëmatësave 2 herë në muaj dhe 16 ekspertiza.											

Raporti i aktiviteteve dhe analizat bakteriologjike Janar – Dhjetor, 2020

Aktivitetet:

- * Kontrolli përmanent i prezencës së klorit residual në kroje.
- * Kontrolli përmanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet, si dhe kontrollimi i klorit në të gjitha fshatrat e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
- * Kontrolli përmanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
- * Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.
- * Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
- * Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit intern .
- * Te stacioni i klorifikimit te „Mulliri i Vjetër” për shkak të mosfunksionalizimit në gjendje të rregullt të sistemit të klorifikimit, bëmë ndërrimin e tërë sistemit sepse ai i mëparshmi ishte shumë i vjetër.

* Ndhmuam në riparimin e sistemit të klorifikimit në stacionin „Pusi i Atit” i cili ishte jashtë funksionit si shkak i ngrirjes së aparaturave.

* Në Prishtinë në „Era Med” ishim për tu furnizuar me reagjent dhe paisje për punë në laborator.

Ishim në Mamushë për të par kushtet e ambientit se ku duhet ta bejmë injektimin e klorit në system,dhe u dakorduar me njesitin e operatives qe ti krijoj kushtet teknike në objekt per instalim te sistemit te klorifikimit.

* Së bashku me përfaqësuesin e firmës „DIAMANTI”viztuam objektet në fshatra ku do i kryejn punimet për montimin e paisjeve për sistem të klorifikimit.

* Vizitë të „Pusi i Atit” për të kontrolluar cilësinë e ujit, ku konstatojmë se uji nga „pusi-1”afër rrugës nuk mund të përdoret për pije për shkak të jo stabilitetit të tijë në turbiditet (rritet turbiditeti dhe e ban ndotjen e tër sistemit).

* Në Prishtinë për të regulluar makinën të „Auto Mita”.

* Vizita dhe kontrolle 24/7 si kujdestar 7 ditë në Javë.

* Pas defektit në gypin furnizues Ø 600 dhe ramjes nga funksioni i sistemit të klorifikimit nga „Mulliri i Vjetër”, aktivizuar sistemin e klorifikimit nga „40-Burimet” konkretisht nga „Komora e Re”.

* Riparim i injektorit në Ø 400 në Shadrvan për mbarvajtje të sistemit të klorifikimit.

Riparuar injektorin në „Komorën Re” në 40-Burime, në Ø600 për të vazhduar klorifikimi i regullt i ujit.

* Pas reshjeve të mëdha dhe rritjes së nivelit të lumit erdhi deri të penetrimi i ujit të lumit në të gjitha burimet në komorën e re dhe atë të vjetër në „40-Burime”dhe ishim të detyruar që pjesën dërmuese të ujit ta largojmë nga sistemi ,dhe të furnizohemi me anë të pompave prej atyre burimeve kun a u dha mundësia,për këtë veprim lajmëruam strukturat e duhura dhe kjo zgjati deri të nesërmen kur edhe gjendja u kthye në normalitet.

* Te „Pusi i Atit” ishim për të evituar problemin me system të klorifikimit.

* Bëmë riparimin e vakumregullatorit në stacionin e klorifikimit të „Mulliri i Vjetër”.

* Bëmë regullimin e injektorit në Ø 400 në stacionin e klorifikimit në „Bunar-1”Shadrvan,

* Bëmë pastrimin dhe dezinfektimin e rezervuarit në Medvec.

* Bëmë riparimin e vakum rregullatorit në stacionin e klorifikimit të Komora e re në 40 Burime.

* Bëmë regullimin e injektorit në Ø 800 në stacionin e klorifikimit në Komorën e re në 40 Burime.

* Bëmë riparimin e injektorit në gypin që furnizon „Rezervuarin në KFOR”.

* Bëmë inspektimin e kryerjes së punimeve mbi vëndosjen e aparaturave të klorifikimit me

* Në stacionin e klorifikimit në Malësi të Re ishim për ta regulluar sistemin e klorifikimit.

* Vizitë në shtëpi private pas ankesës së tyre për „kualitet jo të mirë të ujit”kontrolluam dhe i sqaruam se ku e si duhet të evitohet problem se kishte problem me rrjetin e tijë.

* Riparuar dhe futëm në punë sistemin e dozimit të klorit në stacionin „Novak.

* Inspektuam shtëpi private në fshatin Nashec dhe në fshatin Trepetincë të cilët kishin ankesa për ujën e pijes, ku në të dyja rastet uji ka turbiditet tështuar, të rasti i parë shkak i shtenjë defekt në rrjetin furnizues, kurse rasti tjetër kishte përzierje të ujit të pusit privat dhe ujit të rrjetit, në të dyja rastet i këshilluam për hapat që duhet ndërmarr.

* Ishim për të riparuar injektorin të “Pusi i Atit”me qëllim të funksionalizimit të sistemi të klorifikimit.

* Ishim në trajnim për punën që do e bëjmë me sistemet e reja të klorifikimit që po instalohen në disa zona rurale nga „CDI-ja”përmes firmë „Diamanti”e cila po i kryen punët.

* Hipoklorit të Natriumit nga ana e firmës „Diamanti” si ekzekutuese e punimeve në disa fshatra.

Analizat Bakteriologjike, Janar-Dhjetor / 2020

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	51	29
	Ujësjellës	128	6
Suharekë	Burim	6	3
	Ujësjellës	33	3
Dragash	Burim	11	11
	Ujësjellës	27	2
Malishevë	Burim	4	4
	Ujësjellës	32	2
Totali		292	13

Vrejtje: 1) Në burim, uji i patrajtuar ; 2) Ujësjellës, uji i trajtuar

Analizat Bakteriologjike, ISHP - Prizren Janar - Dhjetor/2020

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	24	0
	Ujësjellës	844	6
Suharekë	Burim	6	0
	Ujësjellës	111	0
Dragash	Burim	4	0
	Ujësjellës	52	0
Malishevë	Burim	6	0
	Ujësjellës	111	0
Totali		1118	6

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është 1118 mostra ku 6 prej tyre nuk i përgjigjen standarteve të ISHP.

3.1.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

3.1.5 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Të gjitha defektet në sistem të ujësjellësit dhe kanalizimit janë sanuar me kohë,
- Është përcjell në mënyre permanente cilësia e ujit të pijës në nivel regjional,
- Është përgaditur dhe miratuar strategjia e UPF-së.

3.1.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me ujë të pijës në gjithë zonën e shërbimit,
- Monitorimi i cilësisë së ujit të pijës në nivel regjional,
- Vazhdimi i analizës së rrejtit të ujësjellësit dhe bartja e të dhënave në GIS,
- Fillimi i implementimit të strategjisë për uljen e UPF-së.
- Aktivitet e shërbimit teknik të ndërmarrur për eliminimin e humbjeve teknike.
 - + Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
 - + Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
 - + Ngritjen e vetedijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajnë ujin në mënyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijës.


3.2 Pasqyrat e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

3.2.1 PRODHIMI

JANAR-DHJETOR 2019 – 2020

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

2019- 2020				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN				
PRODHIMI - m3				
NJËSIA PUNUESE	JANAR-DHJETOR 2019		JANAR-DHJETOR 2020	
	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	381.6	12,034,150	369.0	11,635,488
SUHAREKË	69.0	2,175,749	75.9	2,392,058
MALISHEVË	46.1	1,454,844	46.7	1,473,695
DRAGASH	31.3	988,584	32.3	1,018,991
TOTAL	528.1	16,653,327	523.9	16,520,232
NDRYSHIMI l/sec			(4.22)	(133,095)
NDRYSHIMI %				-0.80%



3.2.2 PRODHIMI

JANAR-DHJETOR – 2020

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

PRODHIMI - JANAR-DHJETOR 2020 (PB-2020)

JANAR- DHJETOR - 2020				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN				
P R O D H I M I - m3				
NJËSIA PUNUESE	JAN-DHJET 2020		JAN-DHJET-2020 (PB)	
	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	369.0	11,635,488	389.5	12,283,390
SUHAREKË	75.9	2,392,058	68.7	2,165,834
MALISHEVË	46.7	1,473,695	46.5	1,465,271
DRAGASH	32.3	1,018,991	31.9	1,004,881
MAMUSHË	-		10.7	336,880
TOTAL	523.9	16,520,232	547.2	17,256,256
NDRYSHIMI l/sec			-23.34	(736,024)
NDRYSHIMI %				-4.46%

Koment:

Arsyeja pse nuk eshte realizuar prodhimi sipas planit te biznesit eshte sepse, kompania nuk ka arrit per shkaqe te ndryshme (ne kete rast pandemia me covid 19) qe te zgjeroj zonen e sherbimit sipas planit te biznesit.

3.3. AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.3.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi një faturim më të madh në krahasim me vitin paraprak prej 39.935 m³. Kjo rritje është rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit. Edhe pse kemi një rritje në faturim, kjo rritje është shumë e vogël në krahasim me rritjen e numrit të konsumatorëve. Periudha e mbylles së bizneseve dhe institucioneve gjatë periudhës së pandemisë, ka zvogëlu konsumin e ujit në këto kategori e me këtë edhe rënien e faturimit. Me poshte gjeni te dhenat tabelare:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca
1	Uji i Faturuar	m3	7,387,826	7,347,891	39,935
2	Konsumatorët Shtëpiak	m3	6,303,630	6,126,411	177,219
3	Konsumatorët Komercial-Industrial	m3	598,505	657,754	-59,249
4	Konsumatorët Institucional	m3	485,691	563,678	-77,987

- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor të secili konsumatorë.
- Me kujdes të shtuar, janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit.
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
- Është rikthyer në punë normale i gjithë stafi i Departamentit Rajonal me Konsumatorë.

3.3.2 RAPORT I ANKESAVE TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	2,549
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	2,549
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	761
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	761
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	761

3.3.3 RAPORT NGA EKIPA E INSPEKTIMIT

- Kanë vazhduar me normalitet, kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët

KRU"Hydroregjioni Jugor" sha

PERIUDHA

RAPORTUESE: Viti 2020

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve e paralajmëruese per permbarim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme te zbuluara	Nr. i shkyçjeve te lidhjeve te paligjshme	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorezuar per gjykatë	Vizita nga ankesat/kerkesat konsumatoreve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	12,058	1,377	31	31	31,684	339	0	550	67,976.47 €
Suharekë	2,897	138	3	3	7,626	225	0	223	63,934.80 €
Malishevë	1,794	199	3	3	2,628	522	0	73	4,866.30 €
Dragash	21	27	10	10	171	30	0	4	1,550.00 €
TOTAL	16,770	1,741	47	47	42,109	1,116	0	850	138,327.57 €

3.3.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Mospagesa e obligimeve te kontraktuara nga nje pjese e madhe e konsumatoreve të cilët kanë nënshkru kontratë për pagesën e borxheve me kiste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare te familjet e tyre nga Covid 19.
- Vazhdon problematika e mos zgjidhjes së problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve. Ky numër vazhdon të rritet për çdo muaj dhe konsiderojm që ky numër në teren është mjaft i madh, sidomos gjatë kësaj periudhe të pandemisë.
- Moszgjidhja e qështjes së borxheve të mëhershme, trashëgimi i borxheve në prona.
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

3.3.5 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kemi aktivizuar dy arka mobile në njësin e Prizrenit për pages ate konsumatorët të cilët nuk kanë paguar mbi 6 muaj.
- Vazhdon implementimi i Up-grade (avansimi i softverit), për faturim, arkat për pagesa dhe departamente tjera në Kompani.

- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyqje dhe legalizimeve.
- Kemi një rritje në inkasim në krahasim me muajin paraprak, si rezultat i mospagesës së obligimeve nga ana e konsumatorëve. Kjo rritje ka ardh si rezultat i fillimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe shtimit të aktiviteteve nga stafi i Departamentit Rajonal me Konsumatorë.
- Ekipet e inspektoratit kane vazhduar punen normalisht.
- Aktivitete me përmbarues privat (dalja ne teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatoreve, trashëgimtarëve të tyre etj), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Nuk janë janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbarimore në terrenet e inkasantëve në qytet .
- Nuk janë vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kisteve nga kontratat për pagesën e borxhit me kiste, mirepo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

3.3.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHEN NE VAZHDIM

- Nga muaji janar 2021, do të fillohet faturimi mobil i konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit. Kjo do të lehtësoj procedurat e faturimit ne kohë dhe njëkohësisht do të zvogëlohet dukshëm kostoja e shtypjes së faturave. Ky aktivitet do të rrisë edhe nivelin e shërbimit në raport me konsumatorët.
- Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit te konsumatorët pa ujëmatës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.


-Jane procedu 24 raste në gjykatë për keqperdorim të ujit.

3.4 PERFORMANCAT- NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATORË

3.4.1 NUMRI I FATURAVE JANAR-DHJETOR- 2020

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN

2020														
No.	Të dhënat	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	JANAR-DHJET 2020
1	Shtëpiak	44,306	44,422	44,527	44,575	44,673	44,812	44,912	45,052	45,344	45,588	45,683	46,013	46,013
2	Ndryshimi	(1,707)	116	105	48	98	139	100	140	292	244	95	330	1,707
					KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellsit ne fshatin Banje (zgjerim i rrjetit, Ø 110mm),lagja e Samadraxhve.	MALISHEVË	90,000.00			30,000.00	30,000.00	30,000.00
2	Zgjerim te rrjetit te ujesjellsit ne Malisheve (Ø 75mm).	MALISHEVË	49,000.00			9,000.00	20,000.00	20,000.00
3	Furnizim me pompa 7.5 kw ne S.P. Banje	MALISHEVË	14,000.00	4,000.00	10,000.00			
4	Furnizim me pompa 7.5 kw ne S.P. ne Maxharr, Kravasari ,Lladroc dhe Shkozë	MALISHEVË	21,000.00	10,000.00	11,000.00			
5	Furnizim me mjete pune (Eskavator, kamion)	MALISHEVË	30,000.00	10,000.00	4,000.00			16,000.00
6	Furnizim me pompa 55 kw ne S.P. Banje	MALISHEVË	45,000.00	22,500.00	22,500.00			
7	Furnizim me pompa 18 kw ne S.P. ne Gurbardh, 11 kw në Bubël	MALISHEVË	15,000.00	5,000.00	10,000.00			
8	Furnizim me mjete pune (Eskavator , kamion)	MALISHEVË	50,000.00	4,000.00			30,000.00	16,000.00

9	Rehabilitimi e gypit magjstral Φ 315mm (Rezervuar Bajë der Malisheve). L= 5.4 km	MALISHEVË	314,000.00		160,000.00	154,000.00	
10	Rehabilitimim I rrjeti Φ 160mm ruga Ibrahi Mazrreku, Malisheve dhe rruga Adem Jashari L=2240	MALISHEVË	72,000.00		72,000.00		
11	Rehabilitimim I rrjeti Φ 75mm-Laxha Miredita Malisheve dhe Laxha Ilaz Agushi L=1780	MALISHEVË	38,000.00		38,000.00		
12	Rehabilitimim I rrjeti Φ 63mm Lumishte,Mirushe,Shkoze ,Turjake,Gurbardh L=1500	MALISHEVË	15,000.00		15,000.00		
13	Ndërtimi I ujësjellësit të ri në fshatin Temeqinë	MALISHEVË	126,000.00				126,000.00
14	Ndërtimi I ujësjellësit të ri në fshatin Janqishtë	MALISHEVË	99,000.00				99,000.00
Totali			978,000.00	55,500.00	381,500.00	234,000.00	307,000.00
EMRI I PROJEKTIT Ujrat e Zeza							
1	Rehabilitimi dhe ndërtimi i kanalizimeve ne Carrallukë	MALISHEVË	30,000.00	5,000.00	25,000.00		
2	Rehabilitimi dhe ndërtimi i kanalizimeve ne Malishevë	MALISHEVË	30,000.00	10,000.00	20,000.00		
Totali			60,000.00	15,000.00	45,000.00	-	-

INVESTIMET

JANAR-DHJETOR - 2020

NJ.P. DRAGASH

	EMRI I PROJEKTIT	NJËSIA	VLERA NË- €	2020			
				INVESTITORI			
			903,050.00	KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Φ 90 mm (Dragash).	DRAGASH	5,950.00		5,950.00		
2	Riparimi i objekteve dhe rivitalizimi i sistemit për trajtimin e ujit të pishëm, Dragash		30,000.00	10,000.00	20,000.00		
3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Φ 200 ACC mm (Dragash).		150,000.00		150,000.00		
4	Ndërtimi I Objektivit te Administrate KRU HRJ njesia punuse Dragash		250,000.00			250,000.00	
5	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Radesh der Dragash		247,500.00		247,500.00		
6	Furnizim me mjete pune (Eskavator, vetura, kamioneta).		40,000.00	10,000.00		30,000.00	
7	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Φ 110 mm (Dragash).	DRAGASH	3,600.00	3,600.00			

8	Furnizim me mjete pune (Eskavator, vetura, kamioneta).	DRAGASH	24,000.00				24,000.00
9	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Ø 125 mm (Dragash der ne Pllave). L= 5km	DRAGASH	50,000.00		50,000.00		
Totali			801,050.00	23,600.00	473,450.00	280,000.00	24,000.00
EMRI I PROJEKTIT Ujrat e Zeza							
1	Rehabilitimi dhe ndërtimi i kanalizimeve ne Dragash	DRAGASH	102,000.00	2,000.00	50,000.00	50,000.00	
Totali			102,000.00	2,000.00	50,000.00	50,000.00	-

INVESTIMET

JANAR-DHJETOR - 2020

NJ.P. MAMUSHË

	EMRI I PROJEKTIT	NJËSIA	VLERA NË- €	2020			
				INVESTITORI			
				KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Ndërtimi i rrjetit furnizues me uje te pijes per komunën e Mamushes dhe vendosja e ujmatesve te konsumatorve ne pron publike ne rruge	MAMUSHË	225,000.00	25,000.00	200,000.00		
			-				
			-		-		
Totali			225,000.00	25,000.00	200,000.00	-	-

INVESTIMET**JANAR-DHJETOR - 2020**

INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE		
Nr		2020
1	NJ.P. PRIZREN	392,600.00 €
2	NJ.P- SUHAREKË	71,000.00 €
3	NJ.P. - MALISHEVË	70,500.00 €
4	NJ.P. - DRAGASH	25,600.00 €
5	NJ.P. - MAMUSHË	25,000.00 €
KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN		584,700.00 €

INVESTIMET NGA GRANTET/ DONACIONET		
Nr		2020
1	NJ.P. PRIZREN	19,216,857.69 €
2	NJ.P- SUHAREKË	6,886,150.19 €
3	NJ.P. - MALISHEVË	967,500.00 €
4	NJ.P. - DRAGASH	877,450.00 €
5	NJ.P. - MAMUSHË	200,000.00 €
KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN		28,147,957.88 €

15. RAPORT NGA MENAGJERET E PROJEKTEVE

15.1 Ndërtimi i kolektorit dhe Impiantit per Trajtimin e Ujerave te zeza – Prizren (ITUN)

Si rezultat I gjendjes jo te kënaqshme te shërbimeve me sistemin e kanalizimit ne aspektin e funksionalitetit për te përballuar ujerat urbane ne përgjithësi duke përfshirë ujerat e zeza, ujerat industriale dhe ujerat e shiut ne qytetin e Prizrenit , ka rrjedh nevojë qe te përpilohet një studim I mirëfilltë për gjendjen e ujerave urbane për qytetin e Prizrenit, prandaj është filluar me Studimin e Fizibilitetit te përpiluar ne vitin 2006 te investuar nga Qeveria Federale Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), konkretisht versionit final te këtij studimi 10/2011 për Asgjësimin e Ujerave te Ndotura ne Kosovën Jugperëndimore, konkretisht Studimi I Fizibilitetit per qytetin e Prizrenit me nr. te projektit 610-1154 , me te vetmin qellim për te ngrite shkallen sanitare për qytetin e Prizrenit ne përgjithësi, për te mbrojtur shëndetin e popullatës, ujerat nëntokësore, ujerat sipërfaqësore ne veçanti, e sidomos për te përmbushur një nder kriteret e Bashkimit Evropian qe Ujerat e Ndotura te shkarkohen ne shtetet tjera si te trajtuara.

Bazuar ne këtë studim te Fizibilitetit si baze për zhvillimin e këtij projekti na është dhuruar granti nga Qeveria Federale Gjermane I cili është realizuar me automatizëm nga ish Presidentja e Republikës se Kosovës shkëlqesia e sajë zonja Atifete Jahjaga, ky Grant I pastër pa asnjë interes është jetësuar përmes dy Marrëveshjeve Financiare te projektit ndërmjet KfW-se si dhurues, Ministrisë se Financave si marres dhe KRU"Hydroregjionit Jugor" si përfitues I këtij Granti te nënshkruara ne vitin 2012.

Marrëveshja e pare është ne vlere prej 8 milion euro (7+1) dhe marrëveshja e dyte është ne vlere prej 4 milion Euro. *(Marrëveshjet financiare origjinale te nënshkruara nga palët gjenden ne Kompaninë KRU"HRJ"sh.a dhe munde te prezantohen ne çdo moment).*

Pas këtyre marrëveshjeve financiare për këtë Project është përpiluar Marrëveshja e Veçantë e cila është jetësuar me nënshkrimin e sajë ndërmjet palëve si: Banka Gjermane për Zhvillim si investitor, Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapsinor si garantuese e fondit nga kontributi vendor, Komuna e Prizrenit – si garantuese e sigurimit te lokacionit ku do te ndërtohet ITUN, konkretisht shpronësimit te tokës se nevojshme për ndërtimin e ITUZ-se dhe fondeve eventuale shtese te cilat do te nevojiten për kompletimin e këtij projekti dhe KRU"Hydroregjionit Jugor" si Agjencion Ekzekutues I Projektit.

Për implementimin e këtij projekti me iniciimin e KfW-se është përcaktuar Agjent Tenderi I cili ka përzgjedhur Kompaninë Konsulentë e cila ka për detyre qe te përgatisë dokumentacionin e tenderit, te dizajnoj projekte sipas kontratës dhe te mbikëqyr projektin deri ne fund te implementimit për te dy fazat e projektit. Kontrata me Kompaninë konsulentë është nënshkruar ne vitin 2013.

Projekti përbëhet prej dy fazave, Faza 1 ka te beje me ndërtimin e kolektorit kryesor ne rrugë ana e majte e rrjedhës se lumit Lumëbardhi se bashku me kapërderdhësit për reshjet e shiut, faze kjo e cila tani me është përfunduar dhe Faza 2, Dizajnimi dhe ndërtimi ITUZ-se e cila është shume afër përfundimit.

Kontrata "Asgjesimi i Kanalizimeve në Jugperëndim të Kosovës; Faza 2 - Dizajnimi, furnizimi dhe instalimi i WWTP në Prizren "u nënshkrua më 5 Maj 2015 midis Punëdhënësit Hydroregjioni Jugor dhe Kontraktuesit, Sipërmarrje e përbashkët (Joint Venture) Aqualia infraestructuras S.A. (si udhëheqës) dhe Hidroterm.

Kushtet e kësejë kontrate Dizajn dhe Ndërtim vlejné sipas Librit te verdhe te FIDIK-ut (FIDIC Yellow Book, Edition 1999). Procedurat e Prokurimit per këtë kontrate u zhvilluan sipas Udhëzimeve të Prokurimit të KfW-se.

Për shkak të vonesave në shpronësimin e tokës dhe çështjeve tjera administrative absolutisht pa fajin e AEP-se qe ka te beje me posedimin e Lejes së Ndërtimit si kusht themelor per fillimin e zbatimit te

kantatës , ndërtimi i WWTP Prizren filloi më **25 qershor 2017**, ndërkaq kontrata me punë kryesin ishte nënshkruar me

5 Maj 2015 qe nënkupton se punimet kishin filluar me një vonese prej 26 muajve, për këtë vonese punëdhënësi bazuar ne marrëveshjen kontraktuale ka qene i obliguar qe te paguaj kompensim prej rreth 320,000.00 Euro neto, këto mjete janë paguar nga komuna e Prizrenit si garantuese e kostos shtese. Kohëzgjatja fillestare e kontratës ishte 18 muaj dhe Data e Përfundimit te projektit u caktua me **31 Dhjetor 2018**.

Gjatë tremujorit të dytë 2018, përparimi i punimeve të ndërtimit filloi të ngadalësohet ndjeshëm. Vonesat kanë ndodhur për shkak të procesit të ngadalte në marrjen e aprovimit nga KEDS per dislokimin e linjes 10 KV (kilovolteshe) e cila duhej te dislokohej dhe kjo leje është lëshuar ndërkohë si dhe përparimit relativisht te ngadalte te disa pjesëve të punëve civile.

Për shkak të kushteve të këqija të motit në dimër përfshirë vitet 2017/2018, në tetor te vitit 2018 sipas konsulences dhe miratimit te KfW-se u vendos që koha e përfundimit te projektit te zgjasë edhe per dy muaj, pra u vendos qe projekti te perfundoj deri me **28 shkurt 2019**.

Sidoqoftë, për shkak të performancës së pakënaqshme të Kontraktuesit, u bë e qartë se punimet e ndërtimit do të zgjasin më shumë. Punëdhënësi HRJ dhe Konsulenti kanë zhvilluar takime të shumta me Kontraktorin për të shpejtuar përparimin e punimeve.

Konsulenti me miratimin e HRJ-se i ka derguar leter kontraktorit Ne muajin Shtator dhe Tetor te vitit 2018 bazuar ne Klauzolen 8.6 te FIDIK-ut qe ka te beje me "Shkallen e progresit te punimeve" me te cilen e ka njoftuar per shkallen e ngadalte te progresit te punimeve dhe ne Janar te vitit 2019 nje leter tjeter per "nivelin e performances se paknaqshme" duke i kerkuar qe te marr masa per rikuperimin e ketyre vonesave.

Pas shume takimeve dhe presioneve tek kontaktori nga ana e konsulentit dhe HRJ-se në një takim te dates 6 Mars 2019, Kontraktori emëroi një "Menaxher të ri te Përkohshëm të Ndërtimit" për të mbështetur Ekipin e Kontraktuesit në vendpunishte deri në përfundimin apo venien ne funksion te impiantit. Me kete angazhim nga Kontraktori fillimi i komisionimit ishte fundi i **qershorit 2019** dhe kjo dukej akoma realiste, mirpo me gjithë optimizmin e përkohshëm, i cili doli nga ai takim, problemet në vendpunishte mbetën të njëjta. Kontraktuesi vazhdonte të tejkalonte orarin e tij dhe i neglizhonte udhëzimet e dhëna nga Konsulenti.

Prandaj, ne si Punëdhënësi me udhezimet nga konsulenti e konsideruam veten qe kemi të drejtë qe te na paguhen demet nga keto vonesa dhe me date **24 maj 2019** e njoftuam me shkrim Kontraktuesit per kete çeshtje.

Në qershor, u vlerësua se para-komisionimi i WWTP Prizren do të fillonte në shtator 2019.

Pas shqetesimit nga KfW si financuese e ketije projekti dhe neve si punedhenes u inicua takimi i parë Special i cili u mbajt në **4 korrik 2019** në zyrën e KfW në Prishtinë. Gjatë Takimit special, u ra dakord per një sërë aktiviteteve te mehereshme që duhej të kishin përfunduar deri në shtator 2019 për te pas mundesi inaugurimin e përfundimit te ketije projekti pargjate festimit te 20 vjetorit të Bashkëpunimit Financiar Gjerman me Kosovën.

Më tej në takim, Kontraktuesi dorëzoi Raporte Javore të Progresit që raportojnë për përparimin e pikave të shtatorit. Inxhinieri monitoroi përparimin gjatë mbikëqyrjes së tij të përditshme të vendpunishtes dhe takimeve javore me Kontraktorin.

Pavarësisht nga kjo, Konsulenti vërejti se progresi ishte prapa afateve të dakorduara dhe se nuk u mor asnjë masë serioze nga Kontraktuesi për të shpejtuar përparimin. Si pasojë, Konsulenti lëshoi disa udhëzime tek Kontraktuesi, duke specifikuar kohën deri në të cilën punimet duhet të përfundojnë.

Gjatë Takimit te dyte Special te mbajtur ne zyret e HRJ-se me date **21 Gusht 2019**, përfaqësuesi i KfW në Kosovë, Drejtori i Përgjithshëm i HRJ dhe Konsulenti kërkuan që numri i punëtorëve në vendpunishte të rritet ndjeshëm.

Aktualisht, rreth 95% e punimeve të ndërtimit kishin përfunduar, por Kontraktori po përballet me vështirësi të përmbushë disa kërkesa të KEDS për transformatorin. Këto kërkesa duhet të përmbushen para se WWTP të lidhet me rrjetin e furnizimit me energji elektrike.

Me kusht që këto probleme të tejkalohen shumë shpejt, Kontraktori parashikon që ITUZ mund të merret në veprim në **dhjetor 2019**.

Duke rishikuar kërkesën e HRJ për pagesa, Inxhinieri "p2m berlin GmbH-IDOM-ALB Architect" përcaktoi që pas **28 shkurtit 2019**, me letrën e tij të datës 26 gusht 2019 në lidhje me përcaktimin për aplikimin e dëmeve të vonesës, Inxhinieri përcaktoi që Punëdhënësi, Hidroregjioni Jugor, ka të drejtë në përputhje me **FIDIC YB, SC 8.7** [Dëmtimet e vonesës] për pagimin e dëmeve të vonesës nga Kontraktori pas datës **6 Korrik 2019**.

Periudha e aplikimit të dëmeve të vonesës u përcaktua të zgjasë deri në leshimin e certifikates për pranimit teknik të perkohshëm (Taking over certificate).

Periudha maksimale për aplikimin e Dëmeve të Vonësës ka skaduar me 14 Tetor 2019. Kjo do nënkuptojë që është plotësuar vlera e dëmeve nga 10 % e kontraktit dhe pas kësaj date HRJ mund të fillojë me aplikimin për kompensim të një pjese të dëmeve për shkak të vonësës.

Prandaj, HRJ ka të drejtë për shumën maksimale të dëmeve të vonësës (10 (dhjetë)% të çmimit të kontraktit përfundimtar në shumën prej 1,035,451.24 EUR në përputhje me FIDIC YB, SC 8.7 [Dëmtimet e vonësës]. Në këtë kusht ekspert i FIDIC-it nga ana e Inxhinierit-konsulencës konfirmoi që Hidroregjioni Jugor ka të drejtë të dërgojë një kërkesë për kompensimin e dëmeve para se të leshohet Pranimi Teknik i perkohshëm. *(Gje të cilën e kundërshtonte kontraktori, duke thënë se pa përfunduar komplet projektin dhe të përcaktohet vlera investive nuk kemi të drejtë të kërkojmë dëmet për shkak të vonësës, gjithashtu kontestoni kohën e cilës u shkaktua në kontestin e kontraktit me KEDS-in).*

Në përputhje me kontraktin, dëmet e vonësës do të llogariten në bazë të çmimit përfundimtar të kontraktit. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton që Dëmtimet e Vonësës mund të aplikohen vetëm pasi të merren punimet dhe të gjitha variacionet dhe pretendimet janë zgjidhur dhe mbyllur.

Në përputhje me **FIDIC YB, SC 2.5** [Kërkesat e punëdhënësit], shumat e pjesëshme të dëmeve të vonësës tashmë mund të zbriten nga IPC-të para se të lëshohet TOC Pranimi Teknik i perkohshëm.

Në këtë drejtim, synohet të zbritet një pjesë e dëmeve të vonësës nga faturat e Kontraktuesit për Kërkesën Nr. 13 (483,339.78 EUR) dhe për Shlyerjen e Parave të Mbajtjes së MESP (481,871.02 EUR). Mbetjet e dëmeve të vonësës arrijnë në $1,035,451.24 - 483,339.78 - 481,871.02 = 70,240.44$ EUR. Synohet të zbritet kjo pjesë e mbetur e dëmeve të vonësës nga faturat e rradhës të Kontraktuesit.

Parakomisionimi I ITUZ-se ka filluar, ne si AEP I kemi dërguar dy teknik dhe 3 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e ITUZ-se dhe Menaxherin Teknik të ITUZ-se, sipas kërkesës së kontraktit do të vendoset stafi I ITUZ-se dhe meqenese trajnimet do të fillojnë nga mesi i muajit shkurt 2020 në jemi në përfundim të rekrutimit të stafit.

Sipas aktiviteteve aktuale të cilat janë duke u zhvilluar dhe sipas orarit të dhënë nga Kontraktori, ITUZ do të fillojë operimin në fund të muajit Prill 2020.

Duke u bazuar në faktin se nga mesi i muajit Mars 2020, Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Shëndetësisë për shkak të COVID 19, shpalli gjendje emergjente në shëndetin publik, aktivitetet në lidhje me zhvillimin e projektit filluan të binin drastikisht, edhe në muajt në vazhdim sidomos në fazën e parë të pandemisë nga Marsi deri në qershor u punua me staf të reduktuar dhe levizja e lirë e mallrave dhe njerezve përfundimisht u ndërpre plotësisht, në këtë periudhë zhvilloheshin aktivitetet me intenzitet shumë të vogël sidomos nga kompanitë vendore pasi që kompanitë e huaja e kishin të pamundur levizjen, nga qershori 2020 deri në nëntor 2020 u zhvilluan disa aktivitete në lidhje me zhvillimin e fazës së parakomisionimit dhe komisionimit të linjës së ujit, mirpo këto aktivitete ishin shumë të ngadalshme nga ana e kontraktit.

Ne trenujorin e fundit te vitit 2020, vazhduam me parakomisionimin, komisionimin dhe leshimin ne funksion te linjes se ujit sidomos me testin 72 oresh, mirpo edhe ne kete faze aktivitetet ishin sporadike.

Ne kete tremujor te vitit 2020 u dorezua nje plan dinamik nga ana e kontraktit dhe u miratua nga ana e konsulences ku sipas ketije plani ITUZ do te perfundoj ose konkretisht do te dorezohet ne fund te muajit SHKURT 2021, sidomos per linjen e ujit, do te perfundoj trajnimi i stafit dh gradualisht do te dorezohet ITUZ tek klienti dhe ne kete faze do t vashdohet me vertetimin e stafit se a eshte ne gjendje te operoj me ITUZ ne kete kohe do te angazhohet edhe kompania DORSCH faza e dyte 18 mujore e cila do ta ndihmoj HRJ-ne ne pavaersimin e operimit me ITUZ.

Vlene te ceket se per sa i perket fondit te garantuar nga Komuna e Prizrenit edhe per gjte shume perpjekjeve nga e gjitha palet, perseri Komuna e Prizrenit nuk ka arrit qe ta permbush obligimin e saje kontraktual ne lidhje me pagesat e mjeteve shtese te cilat i kishte garantuar.

Te gjitha raportet mujore dhe tremujore te perpiluara nga ana e konsulences qe nga fillimi i prjektit e deri ne fund te vitit 2020, i gjeni tek kryetari i komitetit Lulzim Pacarizi dhe mud ti pezantojme ne cdo kohe.

Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale Faza e VI-të

Fillimi i fazës së VI-të

*Jemi në realizim e sipër të projekteve të planifikuara për fazës së VI-të ku disa projekte kanë fillue të realizohen e disa janë në fazen fillestare :

Në Prizren :

- Zona e Hasit , projekti i rehabilitimit të rrjetitështë në fazen e Garancioneve , Investimet në Efiqenca e energjisë elektrike , Rehabilitimi i rezervareve në Kojush1 dhe Kojush 2 , Rezervari i Kobaj , rrjeti i ri ujësjellesit dhe ndërtimi i pusetave në rrugë për Fshatin Mazdrek , punimet në vijim .

Humbjet e ujit :

Izolimi i zonave te reje ,Lagjeja e Kurilles , Zona e Hasit , Dardanija (Ndertimi i pusetave dhe montimi i ujëmatësave në trotuar) , projektet janë në fazen e garancioneve .

Projekte e reja :

Në Suharekë:

*Projekte e sistemeve të reja të ujësjellësave në fshtrat ,Suharekë, Reqan, Njeprebisht, Maqitevë , punimet kan përfundue ,jemi ne fazen e testimeve të rrjetit dhe rezervareve .

***Humbjet e ujit ;**

Fshati Reshtan ndërtimi i rrjetit kryesor dhe ndërtimi i pusetave në trotuar dhe montimi i ujëmatësave per tërë fshatin , Fshatin Studenqan , Fshatin Sopi , faza e garancioneve .

* Ndërtimi i impiantit biologjik për trajtimin e ujrave të zeza në fshatin Bukosh , punimet ne fazen fillestare

Në Malishevë :

Ne Humbjet e ujit në Fshatin Astrazub jane ne fazen garancionit te punimeve .

Investimet e reja në sistemin e ri të ujësjellësave për 13 fshatrat janë fazen e testimit te rrjetit dhe rezervareve . Fshatrat Temeqin dhe Janqisht jane ne fazen e perfundimit te punimeve .

Në vazhdim po ju bashkangjes edhe listen e projekteve me vleren e kontratuar deri me tani :

Investimet: nga Qeveria e Zvicrane dhe Qev. Kosoves , Faza e VI-të
Implementuesi : Dorsch dhe CDI

Nr	Projektet	Nr. Prokurimit	Data	Vlera e kontrtes(€)	Kontraktuesit e Punimeve	Vërejteje
1	Rehabilitimi izonave te matura te ujit (ZMU)Per zvoglumin e ujit -Dardani	0-19-4420-5-2-1	08.08.2019	110,142	N.N.SH" CO Ing"& Hidroprojekt	Faza Garantuese
2	Aktivitet e zvoglimit te humbjeve te ujit te pa faturuar per KRU , Nashec - Sozi	0-18-8930-5-2-1	14/08/2019	58,429	N.N.SH" Hidroprojekt"	Faza Garantuese
3	Aktivitet e zvoglimit te humbjeve te ujit te pa faturuar per KRU , Kurilla - PZ			35,000	N.N.SH" Hidroprojekt"	Faza Garantuese
4	Ndertimi I Sistmit te ujesjellesit per Fshatrat e Komunen MA , Fsh.Janqisht ;Temeqinë				N.N SH "Alafa - I"	Pranimi teknik
5	Ndertimi I Sistmit te ujesjellesit per Fshatrat e Komunen Pz, (Janaina <Landovicë	0-19-3860-5-2-1	06.09.2019	121,063	N.N.SH" Diamanti "	Faza e garancionit
6	Ndertimi I sistemit të ujesjellesit per Fshatrat e Komunen se Suhareke (Neprebisht, Reqan, Maqiteve , Rez. Suhareke)	0-19-5661-5-2-1	22/08/2019	449,974	N.N.SH" K-Ingu "	Faza e testimit
7	Rehabilitimi I rrjetit te ujesjellesit ne zonen e Hasit ,burimi Sozi			314,942	N.N.SH" K-Ingu "	Faza e testimit
8	" Rehabilitimi i zonave të matura të ujit (ZMU) ,për zvogëlimin e ujit të pafaturuar (UPF) RESHTAN - SUHAREKË - RITENDER.."	0-19-6728-5-2-1	.3/10/2019	146,825	N.N.SH" K-Ingu "	Zhvillimi i punimeve
9	" Rehabilitimi i zonave të matura të ujit (ZMU) ,për zvogëlimin e ujit të pafaturuar (UPF) Sopi; Reshtan - SUHAREKË - RITENDER.."			38,000	N.N.SH" Hidroprojekt"	Faza e garancionit
10	Impianti per trajtimin e ujrave te perdorura -Fsh. Bukosh Suharekë			23,000	N.N.SH" K-Ingu "	Zhvillimi I punimeve

1,297,375

RAPORT NGA MENAGJERET E PROJEKTEVE

PROJEKTI PËR RIPËRTRITJE TË ENERGISË DHE ENERGISË EFIÇIENTE

1. Titulli i programit;	Projekti rajonal - Prizren për ripërtrirje të energjisë dhe energjisë efiçiente.
Titulli I projektit;	“Ndërtimi i gypsjellësit të ri në segmentin 40 Bunarët – rez. ‘Shpati’ respektivisht kyçja në rrjetin e qytetit të Prizrenit”.
Përfituesi;	KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren
Donatori;	Qeveria Gjermane – BMZ - 2007 65 941
Agjensioni financiar;	KFW – Banka zhvillimore
Fondi total i programit;	2.5 mln Euro
Data e Marrëveshjes;	11.12.2013
Palët e marrëveshjes;	1. KFW, 2. Ministria e Financave e Republikës së Kosovës 3. KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, Prizren
Konsulenca;	p2mberlin – ndërmarrja kryesore IDOM – partner Alb-Architect, nënkontraktor
Data e kontratës me konsulencën;	14.05.2014
Punëmarrësi;	“RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus”
Data e kontratës;	17.05.2017
Vlera e kontratës;	<u>1,925,152.68 €.</u>
Plani dinamikn I paraparë;	9 muaj
Plani i dinamik i propozuar;	17 Korrik 2017 – 17 Prill 2018 (9 muaj)
Plani dinamik i reviduar;	17 Gusht 2017 – 5 Nëntor 2018 (446 ditë)
Plani dinamik rireviduar;	09.10.2017 - 13.02.2019
Përfundimi I punimeve;	20.06.2019
Periudha e përgjegjësisë dhe përfundimt të projektit;	Një vit pas përfundimit të punimeve dhe pranimit teknik (Qershor 2020)
Memorandumi i Mirëkuptimit (MM):	Pas disa takimeve konsultative dhe shkëmbimit të

informacioneve e të dhënave të kërkuara, me datën 15.12.2016 është nënshkruar MM në mes 4 palëve; MI, KK-Prizren, KRU “Hidroregjioni Jugor” dhe konsulenca “p2mberlin”. Me këtë MM është siguruar edhe Pëlqimi adekuat për zhvillimin e punimeve konform lejes urbanistike dhe konditave të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Punimet shtesë për shkak të zhvendosjes së trasës:

- Studimi gjeoteknik (16.08.2017)

Ridizajnimi i trasës (05.10.2017)

Barazimi financiar i punimeve shtesë sipas urdhëresave të aprovuara nga KFW.

Harmonizimi i planit dinamik konform ndryshimeve (3 muaj vonesë e arsyeshme në emër të aktiviteteve të mësipërme)

Pëlqimet dhe aprovimet përkatëse shtesë.

Statusi i fillimit të punimeve – Tetor 2017:

- Punimet kanë filluar me datë 09.10.2017 (3 muaj me vonesë për arsyet e mësipërme)
- Vazhdon furnizimi me gypa PEHD OD 800 dhe OD 630 mm
- Është kërkuar nga banka – KFW, aprovimit i urdhërit për ndryshimin e punimeve për kanal - nr. 2, në vlerë rreth 395 mijë €.
- Jemi në fazën finale të harmonizimit të punimeve në ndërtimin e komorës së re mbledhëse të 40 Burimet dhe ndërrimin e trasës së re të gypave 2 x \varnothing 400 mm dhe \varnothing 225 mm duke përfshirë edhe ndërtimin e pusëve 1 dhe 2 me dimensione të reja konform situacionit të ri të punimeve në Task “B”.

Statusi final i përfundimit të punimeve (20.06.2019);

Sipas planit të paraparë dinamik, pas vendosjes complete të gypsjellësit PEHD OD 800 mm² në gjatësi $L \approx 3.2$ km, nga komora mbledhëse të “40 Burimet” gjer te rezervuari kryesor i qytetit – “Shpati”, janë përfunduar punimet e parapara sipas kontratës duke përfshirë edhe punimet shtesë në të gjitha njësitë punuese të këtij projekti:

- Është përfunduar komora mbledhëse CC700 te lokacioni “40 Burimet” duke respektuar standardet bashkohore për trajtimin e ujit të pijes, që akumulon të gjitha burimet ekzistuese dhe burime tjera të ujit të pijes në perspektivë.
- Janë përfunduar kyçjet e rrjetit të vjetër në infrastrukturën e re hidraulike të CC700.
- Është përfunduar kyçja e gypsjellësit të ri në rezervuarin kryesor – “Shpati”
- Janë përfunduar testimet, dezinfektimet dhe pastrimet e rrjetit të gjithmbarshëm hidraulik të gypsjellësit.
- Është lëshuar në shfrytëzim gypsjellësit kryesor me infrastrukturën përcjellëse hidraulike
- Janë përfunduar punimet në rregullimin e terrenit, mureve dhe bazave mbrojtëse dhe disa punime tjera rreth përmirësimit të vërejtjeve të shqiptuara gjatë mbikqyrjes.
- Është lëshuar Çertifikata e pranimit teknik më, 20.06.2019 dhe tërë projekt dokumentacioni tekniko - investiv.
- Nga data 21.06.2019 vazhdon periudha e përgjegjësisë nga kontraktori deri 20.06.2020.

- Jemi në pritje të raportit final nga konsulenca (brenda javësh), që duhet të aprovohet nga departamenti financiar pranë KFW-së dhe që duhet të përfshijë të gjitha të dhënat dhe informatat rreth projektit dhe punimeve deri te objektivat, efektet dhe benefitet nga ky investim.

Statusi final pas përfundimit të përgjegjësisë së kontraktorit dhe mbylljes së projektit (20.06.2020);

- Sipas kritereve kontraktuese, pas pranimit teknik të projektit, përgjegjësia e kontraktorit për punimet e ekzekutuara është në kohëzgjatje prej një viti kalendarik përkatësisht data 20.06.2020.
- Gjatë kësaj periudhe kohore nuk janë shfaqur probleme që vlen të theksohen për funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të gypsjiellësit dhe infrastrukturës përcjellëse dhe çdo segment e këtij projekti ka përmbushur plotësisht objektivat dhe rezultatet e pritura.
- Janë dorëzuar të gjitha garancionet e sigurimit kontraktorit brenda afatit të paraparë dhe është ekzekutuar pagesa e mbetjes prej 5 %.
- Data 20.06.2020 konsiderohet data e përmbylljes së të gjitha aktiviteteve të parapara të projektit.

Pagesat e ekzekutuara - Gypsjiellësi:

Avansi në vlerë;	288,256.90 € (15 %).
IPC 1.....	148,130.13 Euro
IPC 2.....	267,921.60 Euro
IPC 3.....	157,019.42 Euro
IPC 4.....	308,591.94 Euro
IPC 5.....	254,629.94 Euro
IPC 7.....	163,812.54 Euro
IPC 10.....	188,034.12 Euro
IPC 11.....	162,831.87 Euro
5 % e ndalesës...	102,064.66 Euro

Gjithsej të paguara ; 2,041,293.12 euro (pa TVSH)

Konsulenca (p2mberlin):

Gjithsej deri 12/2019.....	436,488.71 Euro
Mbetja për 12/2020.....	16,548.00 Euro

Gjithsej të parapara për pagesë; 453,036.71 Euro (pa TVSH)

Gjithsej; Gypsjiellësi + konsulenca

Gypsjiellësi.....	2,041,293.12 Euro
Konsulenca.....	453,036.71 Euro

Gjithsej të parapara për pagesë; 2,494,329.83 Euro (pa TVSH)

Mbetja nga fondi 2.5 mln Euro;

5,670.17 Euro (pa TVSH)

Impianti - Gypi shkarkues;

IPC 6.....	137,691.62 Euro
IPC 8.....	74,101.11 Euro
IPC 9.....	30,174.93 Euro

Gjithsej të paguara ; 241,967.66 Euro (pa TVSH)

Mbështetja nga Komuna e Prizrenit përmes Marrëveshjes nr. 2573/12.10.2018;

NPT "Xërxa",	129,872.70 Euro
"RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus",	69,733.62 Euro

Gjithsej të paguara ; 199,606.32 Euro (me TVSH)

Mbështetja nga KRU "Hidroregjioni Jugor", Marrëveshja nr. 548/30.03.2018

"RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus", 108,205.30 Euro

Gjithsej të paguara ; 88,445.75 Euro (me TVSH)

Rekapitullim i të gjitha mjeteve të investuara për gypsjellësin:

KFW.....	2,041,293.12 Euro (pa TVSH)
Komuna e Prizrenit (Marrëveshja 2573/12.10.2018).....	169,066.55 Euro (pa TVSH)
Ministria e Infrastrukturës (Zotimi 4286/11.05.2018-asfalti)	205,889.27 Euro (pa TVSH)
KRU" Hidroregjioni Jugor" SH.A (Marrëv. 548/30.03.2018)...	74,958.48 Euro (pa TVSH)
KRU" Hidroregjioni Jugor" SH.A (fondi i mirëbesimit).....	33,880.00 Euro (pa TVSH)
KRU" Hidroregjioni Jugor" SH.A (punimet shtesë).....	118,282.42 Euro (pa TVSH)

Gjithsej; 2,643,369.84 Euro (pa TVSH)

Objektivat dhe përfitimet;

Donacion në vlerë rreth 2.5 mln Euro, pa asnjë detyrim kthimi.

Zëvendësimi i gypave ekzistues të azbestit me gypsjellës tip PEHD, i impregnuar dhe i veshur me të gjitha shtresat e avansuara mbrojtëse, identifikuese dhe sinjalizuese me dimensione DN-700 mm, OD 800 mm. Me këtë zëvendësim është përfituar në :

Përmbushja optimale e standardit për shërbim të konsumatorëve

Ruajtja e shëndetit public përkatësisht shmangija dhe privimi nga mundësia e efekteve kancerogjene.

Reduktimi maximal i humbjeve të ujit gjatë prurjes (transmisionit).

Uljen e kostos së mirëmbajtjes dhe lehtësi e sanimit të prishjeve. Këto intervenime në gypsjellësin e vjetër (azbestit) krijonin shumë vështëresi punuese, rrezikshmëri për shëndet e ambient dhe kanë gjeneruar në vazhdimësi kosto të lartë për shkak të specifikave intervenuese.

Prurja e ujit të pijes në gypsjellës me kapacitet minimal $Q = 530 \text{ l/s}$ që korrespondon mjaftueshëm për rreth 230 mijë banorë, sipas kalkulimeve të raportit $200 \text{ l/person/ditë}$.

Akumulimi i të gjitha burimeve dhe prurjes së tërë sasisë së ujit në të gjitha periudhat përfshi edhe periudhat e rritjes maksimale të kapaciteteve të puseve që sigurohet në vendburimin 40 Burimet, burimet ndihmëse dhe burimet që mund të sigurohen në perspektivë në këtë zonë.

Siguria dhe mbrojtja adekuate e cilësisë, kualitetit dhe kuantitetit të ujit të furnizuar.

Sipas studimit të fisibilitetit, është projektuar mënjanimi nga prodhimi i 3 elektropompave me fuqi $3 \times 45 \text{ kW}$ të stacioneve pompuese Bunar I dhe II respektivisht ulje e konsumit energjetik për $\approx 370000 \text{ kWh}$ apo mesatarisht rreth $27,000.00 \text{ €}$ në vit. Ky objektivi ende nuk është realizuar sepse disa zona tjera të qytetit të cilat nuk mbulohet furnizimi nga gypsjellësi I ri, për shkak të thatësisë të gjatë dhe zvogëlimit të kapaciteteve të puseve, për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë edhe për këto zona të lartëcekura, po sigurohet ujë nga gypsjellësi I iri dhe po detyrohem në aktivizimin e të gjitha pompave në dispozicion për zonat tjera të qytetit sikurse edhe për shkak të shtimit të lagjeve dhe konsumatorëve të ri. Sipas matjeve dhe analizave aktuale, rezulton se kjo gjendje do të ketë jetëgjatësi të shkurtër duke llogaritur në stabilizimin e kapaciteteve ujore të qytetit dhe duke u përkrahur me aktivitetet që vazhdojnë pandërprerë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Sipas analizave nga shërbimi teknik i Kompanisë, duke krahasuar gjendjen paraprake të furnizimit dhe gjendjen pas vendosjes së gypsjellësit në zonat e furnizimit si më poshtë:

Lagje Dardania	-	Lagje Gurishta
Rr. Ukë Byryqi	-	Lagje Kurilla
Rr. Janina	-	Lagje Bazhdarana

Pas vendosjes së gypsjellësit të ri, kemi këto efekte:

Furnizimi me ujë për 24 h (para gypsjellësit të ri furnizimi për këto lagje ishte prej 9 deri 16 h në ditë), stabilizimi i presionit të ujit në zonat e epërme të qytetit dhe menjanimi nga funksioni i hidroforeve personal që kanë gjeneruar shpenzime shtese për konsumatorët.

Sipas llogaritjes së përafërt, për zonat e sipërshenuara, që rezulton rreth 3000 konsumatorë apo rreth 17000 banorë, nga numri i konsumatorëve me shfrytëzim të paisjeve shtëpiake për ngritjen e shtypjes së ujit (hidroforëve) dhe konsumit energjetik për to, rezulton se brenda vitit vetëm kursimi i energjisë elektrike nga ndërprerja e punës së hidroforëve, arrin në 398500 kWh apo $27,900.00 \text{ €}$.

Llogaritja e përafërt:

$3000 \text{ kons} \times 50 \% = 1500 \text{ kons} \times 0.650 \text{ Wat} = 975 \text{ kW} \times 16\text{h} \times 7 \% = 1092 \text{ kWh/ditë} \times 365 \text{ ditë} = 398500 \text{ kWh} \times 0.070 \text{ €} = 27,900.00 \text{ €/vit}$.

Për sqarim plotësisht, këtij raporti ia bashkangjesim hartën zonale të qytetit të identifikuar me zonat që kanë përfituar nga gypsjellësi drejtpërdrejtë dhe indirekt.

Komora e re mbledhëse (CC700) mundëson menaxhimin efikas, monitorimin, kontrollin, klorinimin, matjet dhe preventimin e ndotjes eventuale nga të reshurat.

Mundësia e ndarjes zonale dhe operimit efikas gjatë ndërprerjeve selective të linjave furnizuese të qytetit (task B)

Ritja e besimit dhe disponimit qytetar.

Aktivitetet e perealizuara në mungesë fondesh;

Ndërtimi dhe funksionimi i Njesisë së klorinimit – sipas pozicionit opcional në kontratë - 158,965.00 €
Renovimi, izolimi, dezinfektimi dhe ndërrimi I infrastrukturës hidraulike të rez. “Shpati”.

Ndërrimi I gypit ekzistues AC Ø 630 mm nga Rez “Shpati” gjer te nyja zonale “34”, në gjatësi L = 200 m.

Ndërtimi i infrastrukturës complete të hapësirës së zonës përkufizuese të 40 Burimet sipa zonave të sigurisë dhe projektit detal zbatues.

Dokumentacioni;

Është dorëzuar komplet dokumentacioni tekniko-investig nga konsulenca (p2mberlin & IDOM&Alb-Architect) me datë 20.06.2019.

Është dorëzuar dokumentacioni, korrektimi dhe vlerësimi final i punimeve shtesë nga konsulenca (p2mberlin & IDOM&Alb-Architect) sipas Ref. nr. R/I: 88, e datës 05.11.2018 dhe Ref. nr. R/I: 118, datë 18.04.2019, në shumën përfundimtare : 118,282.42 €, të cilat nuk janë paguar brenda projektit për shkak të fondit të limituar por të cilat duhet të procedohen për pagesë nga burimet tjera alternative apo nga KRU “Hidroregjioni Jugor”.

Raportit I bashkangjiten:


Marrëveshja nr. 548/30.03.2018, në mes palëve të nënshkuara: KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh.A dhe “RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus”, shoqëruar me tërë dokumentacionin tekniko – investig.

Marrëveshja nr. 2573/12.10.2018, në mes palëve të nënshkuara: KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh.A dhe Komuna e Prizrenit, shoqëruar me tërë dokumentacionin tekniko – investig.

Memorandum Miërkuptimi, nr. 1644/15.12.2016, në mes palëve të nënshkuara: KFW&MI&KK-Prizren&KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh.A.

Zotimi nga MI, nr. 4286/11.05.2018, për përkrahje në asfaltimin e trasës të paraparë të gypsjellësit, në gjatësi; L ≈ 3.2 km.

Tërë dokumentacioni përcjellës teknik, financiar, administrativ, shkëmbyes e i ngjajshëm.



Mënjanimi I ujërave të zeza në Europën Jugperëndimore. (Faza V)

Titulli I projektit;	“Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”.
Përfituesi;	KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren
Donatori;	Qeveria Gjermane–KFW/BMZ–2015.6705.6/Prizren – V/WC-1.3
Agjensioni financiar;	KFW – Banka zhvillimore
Fondi total i programit;	8 mln Euro
Data e Marrëveshjes;	04.10.2019
Palët e marrëveshjes;	1. KFW, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës 2. KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, Prizren 3.KRU Hidrodriini” – Pejë 4.KRU “Gjakova” – Gjakovë
Konsulenca;	SRP, Schneider + Partner Hidroing-DK
Punëmarrësi;	“KWE – Kosova Water and Energy” shpk, Prishtinë
Kontrata;	3551/26.11.2019
Vlera e kontratës;	<u>612.215.00 €.</u>
Data e fillimit të punimeve;	13.01.2020
Plani dinamik I paraparë;	300 ditë kalendarike
Plani dinamik i reviduar;	26.12.2020

Statusi i fillimit të punimeve:

Me datën 13.01.2020 është mbajtur takimi I parë konsultative me punëmarrësin – KWE, me pjesëmarrjen e konsulences dhe menaxhmentiit të Kompanisë. Temë e takimit ishte përgatitja dhe dorëzimi I dokumentacionit final për fillimin e punimeve dhe dakordimi për datën e fillimit të punimeve në teren.

KWE është zotuar që deri me datën 20.01.2020 të përgatisë dhe dorëzoj dokumentacionin e kërkuar dhe është zotuar që punimet në teren të fillojnë me datën 28.01.2020. Punimet në teren kanë filluar me datën 18.02.2020 si rezultat i kushteve atmosferike dhe plotësisimit të dokumentacionit të paraparë.

KRU “Hidroregjioni Jugor”, është zotuar për procedimin e dokumentacionit të duhur për aplikim në institucionet relevante për marrjen e Pëlqimeve dhe lejeve përkatëse për zhvillimin e opunimeve nga kontraktori.

Ekzekutimi i punimeve;

Punimet ekzekutohen në katër aktivitete:

1. Pastrimi I rrjetit me presion me ujë
2. Inçizimi dhe inspektimi me CCTV
3. Testimi I rrjetit me tym
4. Testimi I rrjetit me ngjyrë

Makineria e shfrytëzuar teknike përmbush kriteret e parapara për ekzekutimin e këtyre aktiviteteve sikurse dhe stafi punues.

Efekti covid-19:

Me datën 13.10.2020, kontraktori ka kërkuar kompensimin e ditëve të humbura të punës si rezultat i pandemisë COVID – 19 përkatësisht Vendimeve Qeveritare për ndërprerje të punimeve.

Me datë 16.10.2020, konsulenca – SRP Schneider+Partner ka përgatitur dokumentacionin determinues për KFW, për arsyetimin e kërkesës dhe shumën e paraparë të kompensimit.

Është pranuar shkresa zyrtare nga KFW për aprovimin e kërkesës për kompensim dhe zgjatjet e afatit të planit të paraparë dinamik për kryerjen e punimeve sipas urdhëresës VO1 me këto kompensime:

49 ditë pune
24,990.00 €

Statusi i punëve të përfunduara deri më 31.12.2020:

1. Pastrimi I rrjetit me presion me ujë -	16,164 m	(80.90 %)
2. Inçizimi dhe inspektimi me CCTV -	16,440 m	(82.28 %)
3. Testimi I rrjetit me tym-	14,243 m	(71.29 %)
4. Testimi I rrjetit me ngjyrë -	14,399 m	(72.07 %)

Pagesat e ekzekutuara:

Avansi në vlerë; 122,443.00 € (20 %).

IPC 1..... 48.333,15 €
IPC 2..... 182,779.82 €
VO1..... 24.990,00 €

Gjithsej: 378,545.97 € (58 %)

Të gjeturat dhe konstatimet e deritashme:

Disa segmente të rrjetit të kanalizimit të sendimentuara mbi 50 %

Disa puseta të mbyllura plotësisht gjatë rehabilitimit të rrugëve

Disa linja me sasi të ujit në rrjetë të kanalizimit mbi 70 %

Shumë segmente me gypa të dëmtuar, të shtypur apo devijuar

Cilësia e ujit të ndotur në shumë linja të rrjetit me parametra shumë të ulët se të pritura si rezultat i rrjedhjeve të ujit të pijshëm dhe ujërave atmosferik.

Rekomandimet:

Pastrimi gjeneral periodik i rrjetit të kanalizimit dhe puseta nga njësitë operative të Kompanisë apo kontraktimi i kompanive private të specializuara për këtë veprimtari

Digjitalizimi optimal i rrjetit të kanalizimit

Asistimi profesional i ekspertëve të Kompanisë dhe bashkëpunimi i ngushtë me Drejtëtorinë e shërbimeve publike pranë KK- Prizren dhe institucionet tjera që planifikojnë projekte investive në infrastrukturën e gjithëmbarshme rrugore e ujore me qëllim të zbatimit të kriterëve e standardeve teknike optimale për ndërtimin e tyre.

Plani i propozuar dinamik për përfundimin e punimeve:

Si rezultat i efektit pandemik, kushteve atmosferike dhe mungesës së mjaftueshme të paisjeve makinerike të kontraktorit për ekzekutimin e punimeve, punimet priten të përfundojnë:

Sipas kontraktorit, propozimi i datës finale është 12.02.2021

Sipas konsulencës, propozimi dhe aprovimi i datës finale është 25.02.2021 me sqarimin se kjo zgjatje nuk i ndalon ndëshkimet për vonesë sipas planit të miratuar dinamik (26.12.2020) nëse nuk arsyetohet ndryshe me shkresa zyrtare nga kontraktori dhe aprovohet nga klienti, KFW përkatësisht konsulencë.

**STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

